Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Albanian Microfinance Association

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2024

RAPORTI VJETOR I SHOQATËS

TABELA E PËRMBAJTJES

DY FJALË NGA PRESIDENTI **4**
RRETH SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE **6**
MISIONI DHE VIZIONI 6
VLERAT DHE PARIMET UDHËHEQËSE 6
STRUKTURA ORGANIZATIVE 6
ANËTARËT E SHOQATËS NË VITIN 2024 6
PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMET STRATEGJIKE 7
SEKTORI I MIKROFINANCËS DHE ZHVILLIMET E TIJ **8**
VEPRIMTARIA E INSTITUCIONEVE FINANCIARE JO-BANKA 8
AKTIVITETI KREDITUES I SFJB-VE 8
BURIMET E FINANCIMIT DHE SFIDAT PËR MUNDËSIMIN E TYRE 8
CILËSIA E PORTOFOLIT TË KREDISË DHE PERFORMANCA FINANCIARE 8
UNIONET FINANCIARE DHE SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT **12**
NUMRI I SHOQËRIVE 12
ECURIA E AKTIVEVE 12
ZHVILLIMET NË PORTOFOLIN E KREDISË 12
REZULTATI FINANCIAR I SHKK-VE 13
INSTITUCIONET ANËTARE TË SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE **14**
ZHVILLIMET NË PORTOFOLIN E KREDISË DHE KREDITË E REJA 14
SEGMENTIMI I TREGUT DHE PERFORMANCA SIPAS KATEGORIVE KRYESORE **15**
KREDIA PËR BIZNESE 15
KREDIA PËR BUJQËSINË 15
KREDIA PËR INDIVIDË 16
STRUKTURA E FINANCIMIT DHE KAPACITETI INSTITUCIONAL 16
INSTITUCIONET ANËTARE TË SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE **17**
VEPRIMTARIA E SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE DHE PRIORITETET STRATEGJIKE **23**
AGRO & SOCIAL FUND SHPK 26
CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA (CFFA) 28
FED INVEST SHKK 30
FONDI BESA 32
IUTE ALBANIA 34
KREDO FINANCE 36
MIA FINANCE 38
NOA 40
UNIFIN SHKK 42
PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË SHOQATËS GJATË VITIT 2024 **44**
MBLEDHJE DHE TAKIME 44
KONFERENCA DHE EVENTE 45
TRAJNIME DHE WORKSHOPS 46
EDUKIMI FINANCIAR 48
TAKIME ME INVESTITORË & PARTNERË NDËRKOMBËTARË 49
PJESËMARRJE NË TAKIME DHE AKTIVITETE 50
BASHKËPUNIMI ME RRJETET NDËRKOMBËTARE 52
PREZENCA NË MEDIA DHE INFORMIMI I PUBLIKUT 53

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2024

1 DY FJALË NGA PRESIDENTI

Të nderuar anëtarë të shoqatës, partnerë të dashur, përfaqësues të institucioneve publike dhe private, miq të sektorit të mikrofinancës,

Kam kënaqësinë dhe privilegjin të ndaj me ju disa reflektime në emër të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, në përmbyllje të një viti tjetër të rëndësishëm për sektorin tonë dhe për shoqërinë në tërësi.

Viti 2024 ka qenë një periudhë dinamike dhe sfiduese, por edhe e mbushur me arritje të rëndësishme për institucionet e mikrofinancës në Shqipëri. Në një mjedis ekonomik që vijon të ndryshojë me ritme të shpejta, mikrofinanca ka ruajtur rolin e saj si një faktor i qëndrueshëm zhvillimi, duke mundësuar akses në financa për mijëra individë, mikrobiznese dhe fermerë në të gjithë vendin.

Zhvillimet në sektor kanë qenë domethënëse. Institucionet e mikrofinancës kanë shënuar rritje të qëndrueshme të portofolit, përmirësim të treguesve të performancës financiare dhe operacionale, si dhe rritje të besueshmërisë publike. Viti 2024 ka dëshmuar një orientim gjithnjë e më të theksuar drejt digjitalizimit të shërbimeve, rritjes së përfshirjes financiare dhe forcimit të qeverisjes së brendshme. Po ashtu, janë shtuar përpjekjet për të matur dhe rritur ndikimin social të mikrofinancës, veçanërisht në zonat rurale dhe për shtresat vulnerabël të popullsisë.

Megjithatë, sektori është përballur edhe me sfida të rëndësishme. Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe rregullator, si rezultat i harmonizimit me direktivat europiane dhe nevojës për forcimin e mbikëqyrjes financiare, kanë kërkuar përshtatje të vazhdueshme nga institucionet e mikrofinancës. Rritja e kërkesave për raportim, transparencë dhe kontroll të riskut operacional ka ndikuar në mënyrën se si operojnë institucionet, veçanërisht ato më të vogla. Në këtë kontekst, Shoqata ka qenë aktive në dialogun institucional për të siguruar që zhvillimet rregullatore të jenë të balancuara, proporcionale dhe në funksion të një tregu të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Shoqata ka vijuar të jetë një zë i fuqishëm për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të anëtarëve të saj, duke bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet rregullatore, partnerët ndërkombëtarë dhe aktorët e tjerë të tregut. Gjatë këtij viti kemi qenë aktivë në nisma ligjore dhe rregullatore, kemi ofruar platforma dialogu për çështje të sektorit, dhe kemi avancuar përpjekjet për të forcuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe qeverisjen e mirë.

Po ashtu, Shoqata ka organizuar një sërë aktivitetesh informuese dhe trajnimesh për anëtarët, ka ndjekur me përkushtim zhvillimet ndërkombëtare në fushën e mikrofinancës dhe ka vijuar të promovojë standarde të larta etike dhe profesionale.

Në mënyrë të veçantë, dëshiroj të vlerësoj angazhimin dhe bashkëpunimin e palodhur të anëtarëve tanë, të cilët, me përkushtim dhe ndershmëri, kanë vazhduar të mbështesin individë dhe komunitete në nevojë për financim, duke ndërtuar ura shprese dhe zhvillimi në çdo cep të Shqipërisë.
E ardhmja e mikrofinancës në Shqipëri mbetet premtuese, por kërkon angazhim të përbashkët, inovacion të vazhdueshëm dhe përshtatje me sfidat që sjell teknologjia dhe ndryshimet sociale e ekonomike. Shoqata jonë do të vazhdojë të jetë një faktor aktiv në këtë rrugëtim, duke udhëhequr me vizion dhe integritet.
Ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen dhe besimin, dhe ju ftoj të vijojmë së bashku në misionin tonë për një mikrofinancë më gjithëpërfshirëse, më të fortë dhe më të drejtë për të gjithë.

Me respekt të veçantë,
Arlinda MUJA
Presidente – Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

2 RRETH SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare (AMA) është një organizatë jo-fitimprurëse, e themeluar me synimin për të përfaqësuar, promovuar dhe mbështetur institucionet e mikrofinancës në Shqipëri. E krijuar si një urë bashkëpunimi mes aktorëve të sektorit dhe institucioneve publike, AMA synon të forcojë rolin e mikrofinancës si një mjet zhvillimi ekonomik dhe përfshirjeje sociale, duke garantuar standarde të larta profesionale dhe etike në industrinë e mikrofinancës.

MISIONI DHE VIZIONI

Misioni i Shoqatës është të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të sektorit të mikrofinancës në Shqipëri, duke fuqizuar rolin e institucioneve të anëtarësuara në përfshirjen financiare, mbështetjen e bizneseve të vogla dhe zhvillimin e zonave rurale.

Vizioni i Shoqatës është një treg financiar gjithëpërfshirës, etik dhe i qasshëm për të gjithë individët dhe sipërmarrësit shqiptarë, ku mikrofinanca është e integruar si një komponent i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

VLERAT DHE PARIMET UDHËHEQËSE

Shoqata udhëhiqet nga një grup vlerash thelbësore që përbëjnë bazën e funksionimit të saj dhe të anëtarëve:

- Transparenca dhe Etika – Veprimtari të bazuara në integritet dhe në respektimin e standardeve më të larta të etikës profesionale.
- Përgjegjësia Sociale – Kontribut i qëndrueshëm në përmirësimin e jetës së komuniteteve dhe grupeve të pambrojtura, veçanërisht në zonat rurale.
- Përfshirja Financiare – Zgjerimi i aksesit në shërbime financiare për individë dhe biznese që nuk përfshihen nga sektori tradicional bankar.
- Zhvillimi i qëndrueshëm – Mbështetje për praktikat që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor afatgjatë.
- Partneriteti dhe Bashkëpunimi – Ndërtimi i marrëdhënieve të forta me institucionet publike, rregullatore, organizata ndërkombëtare dhe sektorin privat.

Nëpërmjet aktiviteteve të saj, AMA përfaqëson interesat e anëtarëve përballë institucioneve rregullatore dhe vendimmarrëse, promovon zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale, dhe nxit bashkëpunimin me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar mjedisin e të bërit biznes për institucionet financiare jo-banka që operojnë në Shqipëri.

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Struktura organizative e Shoqatës përbëhet nga:

- Asambleja e Anëtarëve, që është organi më i lartë vendimmarrës;
- Presidenti, i cili drejton Asamblenë e Anëtarëve në vendimmarjen strategjike për zhvillimin e Shoqatës;
- Sekretariati Ekzekutiv, i cili drejton aktivitetin e përditshëm dhe implementon politikat e miratuara nga Asambleja dhe Presidenti;
- Komitete të përhershme dhe të përkohshme, të cilat trajtojnë çështje të veçanta teknike, ligjore apo zhvillimore sipas nevojës së sektorit.

ANËTARËT E SHOQATËS NË VITIN 2024

Në fund të vitit 2024, Shoqata përfaqëson një grup të larmishëm institucionesh financiare jo-banka, që operojnë në fusha të ndryshme të kreditimit, mikrokredisë, pagesave dhe shërbimeve financiare digjitale. Anëtarët përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të sektorit mikrofinanciar shqiptar për sa i përket portofolit të kredisë, shtrirjes gjeografike dhe ndikimit ekonomik-social.

Anëtarët aktivë për vitin 2024 përfshijnë:

- Agro & Social Fund
- Crimson Finance Fund Albania
- Fondi BESA
- Fed Invest SHKK
- ECFA
- Iute Albania
- MIA Finance
- NOA
- UNIFIN SHKK

Disa nga këto institucione janë certifikuar nga Komisioni Europian për përputhshmëri me Kodin e Sjelljes dhe Prakikave të Mira për Mikrokredinë në Evropë, duke treguar angazhimin e tyre për praktika të mira dhe mbrojtje të klientit.

PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMET STRATEGJIKE

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ka zhvilluar një rrjet të gjerë partneritetesh strategjike, si brenda vendit ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, me synimin për të rritur kapacitetin e sektorit dhe për të ndikuar pozitivisht në mjedisin ligjor, rregullator dhe zhvillimor të mikrofinancës në Shqipëri.

Partnerët kryesorë përfshijnë:

- Institucionet publike shqiptare, si Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit dhe Rural, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Investimeve, Agjensia e Inteligjencës Financiare, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), etj.
- Donatorë ndërkombëtarë dhe organizata zhvillimi, si Banka Botërore, IFC, GIZ, BERZH, etj.
- Rrjete dhe shoqata, përfshirë përkatësinë në European Microfinance Netëork (EMN) dhe Microfinance Centre (MFC).
- Institucione arsimore dhe kërkimore, për të promovuar edukimin financiar dhe hulumtimin në fushën e mikrofinancës.

3 SEKTORI I MIKROFINANCËS DHE ZHVILLIMET E TIJ. PRIORITETET STRATEGJIKE DHE FUSHAT KRYESORE TË VEPRIMTARISË

VEPRIMTARIA E INSTITUCIONEVE FINANCIARE JO-BANKA

Në fund të vitit 2024, sistemi financiar shqiptar përfshin 24 subjekte financiare jobanka, pa hyrje të reja në treg, por me një proces të vazhdueshëm përforcimi të standardeve të licencimit dhe kontrollit. Ky proces pasqyron një riorganizim të tregut, me një fokus të shtuar në qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Në këtë kontekst, aktiviteti i SFJB-ve shtrihet në një gamë të gjerë shërbimesh financiare, duke përfshirë kreditimin në forma tradicionale dhe alternative, mikrokreditë, qiratë financiare, faktoringun dhe shërbimet këshilluese dhe ndërmjetëse. Kjo diversifikim shërben si një mekanizëm i rëndësishëm për mbështetjen e segmenteve të ndryshme të ekonomisë, veçanërisht atyre që nuk janë plotësisht të përfshirë nga sistemi bankar tradicional.

AKTIVITETI KREDITUES I SFJB-VE

Totali i aktiveve të subjekteve financiare jobanka që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit regjistroi një rritje të fortë prej 17% gjatë vitit 2024, duke arritur vlerën e 75 miliardë lekëve. Kjo rritje e ndjeshme përfaqëson një sinjal pozitiv për zgjerimin e rolit të këtyre institucioneve në ofrimin e financimeve për ekonominë reale. Pavarësisht sfidave të vazhdueshme makroekonomike dhe rreziqeve të mundshme, SFJB-të treguan rezistencë dhe aftësi për të mbajtur ritmin e rritjes së kreditimit.



1 Grafik nr.1- Totali i aktiveve të IFJB-ve *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

Për t'u përmendur mbetet përqendrimi i lartë i portofolit në disa subjekte kryesore, si Fondi Besa, NOA dhe Iutecredit Albania, që së bashku mbajnë rreth 60% të totalit të aktiveve në sektorin e kreditimit. Ky fakt kërkon vëmendje në drejtim të rritjes së konkurrencës dhe zgjerimit të rrjetit të aktorëve të tjerë për të shmangur rreziqet e përqendrimit.

Në aspektin e strukturës së portofolit të kredisë, dominon kreditimi tradicional me rreth 70% të totalit, ndërsa mikrokredia dhe qiratë financiare mbajnë pjesë të konsiderueshme, duke reflektuar një adaptim të shpejtë ndaj kërkesave të klientëve të ndryshëm, veçanërisht atyre në sektorin informal dhe të vogël të biznesit.



Grafik nr.2- Ecuria e tepricës gjendjet 0-1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

Rritja e kredive të disbursuara ndaj individëve në masën 66% të totalit të kredisë së re tregon një trend të fortë drejt mbështetjes së konsumit dhe nevojave personale, duke reflektuar edhe një përmirësim të nivelit të aksesit të popullsisë ndaj shërbimeve financiare jashtë sistemit bankar tradicional.



Grafik nr.3 Shperndarja e portofolit të 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*



Grafik nr.4 Ecuria e portofolit sipas ve 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

BURIMET E FINANCIMIT DHE SFIDAT PËR MUNDËSIMIN E TYRE

Burimet kryesore të financimit për subjektet financiare jobanka që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit mbeten huamarrjet, të cilat përbëjnë rreth 66% të pasivave, ndërsa kapitali i vetë-subjekteve zë rreth 28%, duke reflektuar nje pozicion të fortë në drejtim të mjaftueshmërisë së tij. Një pjesë e vogël, vetëm 0.8%, sigurohet përmes emetimit të titujve financiarë. Sa i përket origjinës së huamarrjeve, balanca anon lehtë në favor të jorezidentëve, të cilët sigurojnë 51% të fondeve. Kjo strukturë financimi reflekton një varësi të konsiderueshme ndaj burimeve të jashtme dhe një nevojë për diversifikim më të gjerë të fondeve.

Megjithatë, në procesin e sigurimit të burimeve financiare për SFJB-të, ekzistojnë sfida të shumta. Një nga sfidat kryesore është mungesa e aksesit në kapital afatgjatë me kosto të ulët, gjë që kufizon mundësitë për zgjerim të portofolit të kredisë dhe zhvillim të qëndrueshëm. Për më tepër, kushtet makroekonomike të paqëndrueshme, përfshirë ndryshimet në normat e interesit dhe kushtet e tregut financiar, ndikojnë negativisht në përballueshmërinë e financimit dhe stabilitetin financiar të këtyre institucioneve. Gjithashtu, mungesa e një tregu të zhvilluar për kapitalin dhe investimet institucionale kufizon mundësitë për financim inovativ dhe diversifikim të burimeve financiare.

Këto sfida nënvizojnë nevojën për ndërhyrje të koordinuara nga autoritetet rregullatore, institucionet financiare dhe partnerët ndërkombëtarë për të krijuar një ambient më të favorshëm investimi, duke stimuluar zhvillimin e instrumenteve të reja financiare dhe rritjen e transparencës dhe menaxhimit të riskut në sektorin e mikrofinancës dhe veprimtarinë e institucioneve financiare jobanka.

CILËSIA E PORTOFOLIT TË KREDISË DHE PERFORMANCA FINANCIARE

Megjithëse treguesi i kredive me probleme ka shënuar përmirësim, duke rënë në 12.05% të portofolit bruto, ky nivel mbetet një fushë ku duhet ruajtur vëmendja dhe të zhvillohen politika të vazhdueshme për menaxhim të kujdesshëm të rrezikut. Në këtë kuadër, largimi i subjekteve me performancë të dobët tregon edhe përpjekjet e autoriteteve rregullatore dhe sektorit për të krijuar një mjedis më të qëndrueshëm dhe transparent financiar.

Performanca financiare e SFJB-ve është pozitive dhe shfaq një tendencë rritjeje, me fitime neto prej 5.51 miliardë lekësh në vitin 2024, duke treguar që sektori po zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme dhe me kapacitet të mirë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik. Kthimi mbi kapitalin prej 39% dëshmon efikasitet të lartë dhe besueshmëri në menaxhimin e burimeve financiare, duke i bërë këto subjekte tërheqëse për investitorët dhe pjesëmarrësit në treg. Në këtë kontekst, Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës ka një rol kyç në mbështetjen e zhvillimit të institucioneve jo-bankare, promovimin e praktikave më të mira në sektor dhe forcimin e kapaciteteve të anëtarëve të saj për t'u përshtatur me ndryshimet dinamike të tregut dhe rregulloreve. Përpjekjet për të rritur përfshirjen financiare, veçanërisht në komunitetet rurale dhe ndërmarrjet mikro dhe të vogla, mbeten prioritet strategjik, në përputhje me trendet pozitive të rritjes së mikrokredisë dhe kredidhënies.

4 UNIONET FINANCIARE DHE SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT

NUMRI I SHOQËRIVE

Numri i shoqërive të kursim-kreditit (SHKK) dhe i unioneve të tyre mbetet i qëndrueshëm gjatë vitit 2024, duke reflektuar një stabilitet të qëndrueshëm në këtë segment të sistemit financiar jo-bankar. Në fund të vitit operonin 16 SHKK dhe 1 union, prej të cilave vetëm 9 janë pjesë e skemës së sigurimit të depozitave. Ndërkohë, Unioni Shqiptar Kursim-Kredi (USHKK) mbetet i licencuar, por nuk kryen aktivitet operativ.

ECURIA E AKTIVEVE

Aktivet totale të SHKK-ve u rritën në 16.21-miliardë lekë në fund të vitit 2024, duke shënuar një përshpejtim prej 7.3% krahasuar me 2023, kur rritja ishte rreth 6.2%. Kjo rritje e vazhdueshme përfaqëson një tregues pozitiv për zgjerimin dhe konsolidimin e sektorit. Fed Invest mbetet subjekti me peshën më të madhe në portofol, duke përbërë mbi gjysmën e totaleve, ndërsa Alb-Progres dhe Alb Credit gjithashtu kontribuojnë ndjeshëm në këtë rritje. Struktura e aktiveve mbetet e balancuar drejt huadhënies (78%) dhe likuiditeteve (18%), duke reflektuar një strategji konservatore që synon ruajtjen e stabilitetit financiar.

Megjithatë, krahasuar me sistemin bankar, SHKK-të përfaqësojnë një pjesë të vogël të totalit të aktiveve (vetëm 0.77%), duke treguar hapësirë të madhe për zgjerim dhe thellim të rolit të tyre në ofrimin e financimeve mikro dhe kreditimit për individë dhe biznese të vogla që shpesh mbeten të pamundur të shërbehen nga banka tradicionale.

ZHVILLIMET NË PORTOFOLIN E KREDISË

Portofoli i kredisë bruto u rrit në 13 miliardë lekë në 2024, me një zgjerim prej 9% krahasuar me vitin 2023, që ishte 7.6%. Ky përshpejtim është i lidhur ngushtë me performancën e SHKK-ve kryesore, të cilat po zgjerohen në mënyrë aktive në treg. Megjithatë, pjesëmarrja e SHKK-ve në totalin e kredive të sistemit bankar mbetet e vogël (1.55%), duke nënvizuar limitimet në kapacitetin e huadhënies.



Grafik nr.5 Ecuria e portofolit të kredi 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

Treguesi i kredive me probleme është rritur në mënyrë modeste në 4.8%, nga 4.66% në vitin 2023, duke sinjalizuar sfida në menaxhimin e riskut kreditues. Kjo tendencë kërkon përmirësim të mëtejshëm në sistemet e monitorimit dhe rigjenerimit të kredive, si dhe forcim të politikave të menaxhimit të riskut për të shmangur përkeqësime të mëtejshme që mund të rrezikojnë stabilitetin financiar të SHKK-ve.

REZULTATI FINANCIAR I SHKK-VE

Rezultati financiar për vitin 2024 ishte pozitiv, me një fitim neto prej 160.6 milionë lekësh, por me një ulje prej rreth 15% krahasuar me 2023. Kjo rënie lidhet kryesisht me rritjen e shpenzimeve për provigjionet e kredisë, të nevojshme për adresimin e kredive me probleme në rritje. Kthimi nga asetet dhe kapitali po pësojnë një presion në rënie, duke reflektuar sfidat në ruajtjen e rentabilitetit në një mjedis më konkurrues dhe me risk më të lartë. Kthimi nga aktivet ra në 1% në 2024, nga 1.21% në 2023, ndërsa kthimi nga kapitali u ul nga 9.45% në 7.7%.

Sektori i SHKK-ve dhe unionet financiare po vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve financiare për segmentet që kanë akses të kufizuar në sistemin bankar tradicional, duke mbështetur përfshirjen financiare dhe zhvillimin lokal. Megjithatë, sfidat kryesore mbeten përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredive, përballja me kreditë problematike dhe rritja e efikasitetit operacional.

Për të avancuar në mënyrë të qëndrueshme, këto institucione synohet fokus i mëtejshëm si më poshtë:

- Zhvillimin e strategjive të forta të menaxhimit të riskut për të minimizuar rritje potenciale në kreditë me probleme.
- Rritjen e kapitalizimit dhe forcimin e kapitalit për të përballuar presionet financiare.
- Inovacionin në produktet financiare dhe përdorimin e teknologjive të reja për të zgjeruar aksesin dhe përmirësuar shërbimet ndaj anëtarëve.
- Diversifikimin e burimeve të financimit për të reduktuar varësinë nga depozitat dhe për të mundësuar rritjen e kreditimit në kushte të qëndrueshme.

Këto hapa janë thelbësorë për të rritur potencialin e SHKK-ve dhe unionit financiar për të mbështetur më mirë ekonominë mikro dhe sektorët që janë më të ndjeshëm ndaj mungesës së financimit.

5 INSTITUCIONET ANËTARE TË SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare në planet e veta synon përfshirjen e të gjithë institucioneve financiare jo-banka që e gjejnë veten në aktivitetin, prioritetet dhe misionin e saj.

Gjatë vitit 2024, institucionet anëtare të Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancës kanë vijuar të konsolidojnë pozicionin e tyre në tregun financiar, duke reflektuar një performancë të qëndrueshme dhe progresive në drejtim të financimit të ekonomisë, mbështetjes së individëve dhe bizneseve të vogla, si dhe nxitjes së zhvillimit rural. Treguesit kryesorë financiarë tregojnë një rritje të kontrolluar të veprimtarisë kreditore, një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së portofolit dhe një kapacitet të lartë për të përballuar sfidat e ambientit rregullator dhe ekonomik.

ZHVILLIMET NË PORTOFOLIN E KREDISË DHE KREDITË E REJA

Portofoli total i kredisë së institucioneve anëtare u rrit me 12.2% gjatë vitit 2024, duke ruajtur ritmin pozitiv të rritjes krahasuar me vitin paraardhës (+11.5%). Rritja është reflektuar edhe në volumin e kredive të reja të dhëna, i cili është rritur me 12%, krahasuar me 9% në vitin 2023. Ky trend demonstron besueshmëri për institucionet e mikrofinancës dhe aftësinë e tyre për të adresuar nevojat financiare në segmente ku sektori bankar prezanton kufizime në mbulim.



Grafik nr.6 Portofoli aktiv I institucio 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

Treguesi i kredive me probleme (NPL) është stabilizuar në 6.28%, një nivel ndjeshëm më i ulët se ai mesatar i institucioneve të tjera financiare jo-banka (12.05%, sipas BSH). Ky tregues është rezultat i drejtpërdrejtë i politikave prudente të riskut, përdorimit të modeleve analitike për vlerësimin e klientit dhe aplikimit të kritereve të qarta të kreditimit. Diversifikimi i klientelës, shpërndarja gjeografike dhe orientimi drejt aktiviteteve produktive janë faktorë që kanë ndihmuar në ruajtjen e cilësisë së portofolit.

6 SEGMENTIMI I TREGUT DHE PERFORMANCA SIPAS KATEGORIVE KRYESORE

KREDIA PËR BIZNESE

Gjatë vitit 2024, portofoli i kredive për biznese ka shënuar një rritje të moderuar prej 5%, ndërkohë që numri i kredive aktive ka shënuar një rënie me 6%. Kjo dinamikë lidhet me rritjen e konkurrencës nga sektori bankar dhe rënien e lehtë të kërkesë në segmentin mikro. Pavarësisht kësaj, fleksibiliteti, shpejtësia dhe qasja direkte ndaj klientit e mbajnë mikrofinancën si opsionin kryesor për shumë biznese familjare dhe fermerë të vegjël.



Grafik nr.6 Portofoli aktiv I institucio 2 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

KREDIA PËR BUJQËSINË

Ky segment ka shënuar një rritje të konsiderueshme prej 31%, duke reflektuar angazhimin e institucioneve anëtare në financimin e sektorëve me akses të kufizuar në kapital. Kredia e re është rritur me 11% në vëllim dhe 14% në numër, ndërsa vlera mesatare e kredisë ka mbetur rreth 2,800 euro. Mikrofinanca mbetet segmenti më aktiv dhe më i pranueshëm në bujqësi, falë fleksibilitetit dhe njohjes lokale të nevojave të fermerëve.



Grafik nr.8 Ecuria e kredisë për bujqësi 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

KREDIA PËR INDIVIDË

Kjo kategori paraqet rritje me 12% në vëllime dhe 24% në kredinë e re, ndikuar ndjeshëm nga zhvillimi i produkteve të vogla konsumatore, të mbështetura nga teknologji bashkëkohore dhe procedura të shpejta. Vlera mesatare e kredisë individuale ka mbetur 82 mijë lekë, e pandryshuar nga viti 2023. Megjithatë, parashikimet për vitin 2025 tregojnë se rregulloret e reja të Bankës së Shqipërisë do të kufizojnë ndjeshëm disbursimet në këtë segment me 25% deri 30%.



Grafik nr.9 Ecuria e kredisë për individ 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

STRUKTURA E FINANCIMIT DHE KAPACITETI INSTITUCIONAL

Anëtarët e Shoqatës vijojnë të mbështesin veprimtarinë me burime të sigurta financimi, si kapitali vetjak dhe huamarrjet nga institucione financiare partnere. Megjithatë këtë, mungesa e aksesit në skema sovrane ose garanci shtetërore, si ato që i ofrohen sektorit bankar, vështron si pengesë për zbutjen e kostove dhe zgjerimin e aksesit në segmente me risk të lartë.



Grafik nr.10 Financimi i veprimtarisë 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

7 INSTITUCIONET ANËTARE TË SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare në planet e veta synon përfshirjen e të gjithë institucioneve financiare jo-banka që e gjejnë veten në aktivitetin, prioritetet dhe misionin e saj.

Institucionet anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare vazhduan me progresione rritje kreditimin e ekonomisë, madje pati një kërkesë në rritje për kreditë nga bizneset. Veprimtaria mikrofinanciare gjatë vitit 2024 konsiderohet me rritje, indikatorë financiarë të qëndrueshëm dhe një administrim të kënaqshëm të burimeve në dispozicion. Anëtarët e Shoqatës në mënyrë të integuar kanë një portofol aktiv prej rreth 49.1 miliardë lekë dhe një portofol kredie prej rreth 41.0 miliardë lekë, me një rritje respektive prej 11%.



Grafik nr.11 Portofol Aktiv / Volum I di 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

Përsa i takon cilësisë së portofolit të kredisë, sipas shifrave të raportuara nga anëtarët, gjatë vitit 2024 u reflektuan numra të njejtë me vitin e kaluar duke folur për një stabilitet në treg. (shifrat u referohen vetëm anëtarëve të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare).

Institucionet anëtare kanë marrë masat përkatëse duke rritur nivelin e provigjonimit për kreditë me probleme, kryesisht të financuara nga kapitali i vet dhe kontributet e aksionerëve në formën e injektimeve të reja.

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2024



Grafik nr.12 Kredi të dhëna sipas llojit 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*



Grafik 14 -Sektorët e mbështetur nga IFJ 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

Kreditë e akorduara në numër në total për vitin 2024 ishin 314,873, nga të cilat aktive në fund të dhjetor 2024 ishin 180,344. Ndërkohë, e parë në kredi të dhëna sipas segmenteve të tregut, kryesojnë kreditë akorduar për individët, të cilat zënë rreth 60% të numrit të përgjithshëm të kredive të dhëna gjatë vitit 2024. Pas tyre renditen përkatësisht kreditë për bizneset dhe ato për bujqësinë, të cilat zënë përkatësisht 31% dhe 9% ndërkohë që rreth 1% e numrit të kredive të dhëna janë akorduar në kategori të tjera.



Grafik 13 - Volumi i disbursimeve sipas 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*



Grafik 15 – Kreditë e dhëna dhe kreditë 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*



Grafik 16 – Kredia mesatare e dhënë sipa 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

Vihet re një rritje prej 10% ne kredinë mesatare te dhënë për bujqësinë dhe 26% tek kredia mesatare e dhënë për bizneset. Ndërkohë që kredia për individin qëndron në nivele të njëjtat me vitet e kaluara. Ky është një tregues për rëndësinë në rritje të sektorit të mikrofinancës për financimin e bizneseve dhe lehtësimin e lëvizjes ekonomike në vend.



Grafik 17 -Kreditë e dhëna në numër sipa 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

Vihet re një shtrirje me e gjërë në zonat rurale gjate vitit 2024, i cili është një tregues për rritjen e aksesit në financim si nëpërmjet shtrirjes fizike ashtu dhe në digjitalizimin e procesit të dhënies së kredisë. Të gjithë anëtarët e shoqatës vijojmë të marketojmë produktet financiare edhe në zonat rurale, me fokus të veçantë bujqësinë dhe sipërmarrjen familjare në këto zona.



Grafik 18 -Kreditë aktive në numër sipas 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

Sektori i Mikrofinancës ka një zgjerim të madh fizik dhe si pasojë dhe një fokus në punësimin e duhur për të qënë në shërbim të klientit me cilësi dhe korrektësi. Sektori numëron mbi 1864 të punësuar, prej të cilëve 886 oficerë kredie. 10 institucionet e mikrofinancës numërojnë në total një rrjet prej 290 degësh të shtrira në gjithë vendin. Gjithashtu sektori punëson profesionistë të gjitha moshave duke patur një fokus në moshën 30-45 vjeç të cilët janë dhe mosha e cila vendos ekonominë më shumë në lëvizje. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet rritja e numrit të përfaqësuesve femra në nivel të lartë menaxherial. 63% e insitucioneve financiare jo banka ,anëtare tona kane staf drejtues gra nga 41%-60%



Grafik 19 -Numri i stafit të punësuar dh 1 *Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare*

Vihet re një rritje e konsiderueshme e financimit të gjinisë femërore në vend pothuaj me 40% me shumë se vitet e tjera, e cila dëshmon për mbështetjen gjinore në sektorin e mikrofinancës si pasojë e mbështetjes dhe edukimit financiar të vazhdueshëm.

TENDENCAT STRATEGJIKE DHE DIXHITALIZIMI

Institucionet anëtare kanë investuar ndjeshëm në dixhitalizimin e proceseve të kreditimit, vlerësimit të riskut dhe shërbimit ndaj klientit. Kjo ka sjellë ulje të kohës së përpunimit të aplikimeve, rritje të efikasitetit dhe ndërtim të besimit me klientët. Për me tepër, pjesa dërrmuese e institucioneve kanë filluar të integrojnë kritere ESG në strategjitë e tyre operacionale.

PËRFUNDIM

Viti 2024 paraqet një vit progresi të qëndrueshëm për sektorin e mikrofinancës, duke reflektuar kapacitetin e lartë të institucioneve anëtare për të ruajtur balancën midis zgjerimit të portofolit dhe menaxhimit efektiv të riskut. Rritja e moderuar, cilësia e portofolit, orientimi drejt bujqësisë dhe individëve, si dhe investimi në dixhitalizim përforcojnë rolin e mikrofinancës si aktor kyç në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës mbetet e angazhuar në mbrojtjen e interesave të sektorit dhe në nxitjen e politikave që sigurojnë qasje të barabartë, qëndrueshmëri dhe ndikim afatgjatë në jetën e qytetarëve dhe në zhvillimin e ekonomisë vendase.

8 VEPRIMTARIA E SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare operon në kontekstin specifik ekonomik me objektivin përfundimtar për t'i shërbyer zhvillimit ekonomik të ardhshëm të vendit, dhe në veçanti për të nxitur krijimin e vendeve të punës dhe përfshirjen financiare të individëve të vetëpunësuar, fermerëve, sipërmarrësve të vegjël dhe NVM-ve, përmes forcimit të sektorit të mikrofinancave dhe institucioneve që veprojnë në të.

Veprimtaria e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare është pjesë e një përpjekje kolektive dhe të përbashkët midis institucioneve të saj anëtare, për të rritur vizibilitetin institucional në ndikimin që ka mikrofinanca në ekonominë kombëtare. Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ka një rol të ndjeshëm në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës që rregullon veprimtarinë e mikrofinancës në Shqipëri, duke promovuar praktikat më të mira, duke ndarë njohuritë dhe duke prezantuar instrumente të reja financiare midis anëtarëve të saj dhe publikut të gjerë. Mbështet konsolidimin teknik dhe institucional të anëtarëve të saj, duke shkëmbyer praktikat më të mira dhe duke identifikuar trendet financiare dhe ekonomike.

Viti 2024 ka qenë një vit me angazhime të rëndësishme nga ana e shoqatës dhe anëtarëve të saj. Gjatë këtij viti u konsolidua më tej pozicioni i Shoqatës si një aktor i rëndësishëm në nismat dhe zhvillimet që i takojnë tregjeve financiare. Nëpërmjet bashkëpunimeve të vendosura dhe ndërveprimit institucional, Shoqata koordinoi veprimtaritë për të rritur nivelin profesional të qeverisjes korporative, aftësive institucionale për të përmirësuar klimën e sektorit financiar, nivelin e edukimit dhe përfshirjes financiare, standartet e larta të aftësive teknologjikë që ofrojnë shërbim të shpejtë dhe me cilësi, duke ndikuar në eksperiencën e klientit, etj.

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2024

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Albanian Microfinance Association

AGROKREDIT

Agro & Social Fund

CFF
Crimson Finance Fund

FED invest

FONDI BESA
INSTITUCION FINANCIAR

iute

Kredo.al

MiA finance
Microcredit Institution Albania

NOA
INSTITUCION FINANCIAR

UNIFIN
SHOQËRI KURSIM KREDITI

AGRO & SOCIAL FUND SHPK

"Agro & Social Fund" edhe përgjatë vitit 2024, ushtroi aktivitetin e saj në kuadër të përmbushjes së misionit dhe objeksioneve strategjike dhe operacionale. Viti që u mbyll konfirmoi më së miri qëndrueshmërinë e institucionit, ku veprimtaria e tij vijoi zgjerimin e rritjen në nivele të mira. Edhe pse 2024 vazhdoi të jetë një vit me paqëndrueshmëri ekonomike në vend, ku efektet e rritjes së çmimeve nga njëra anë dhe rritjes së konkurencës nga ana tjetër ishin të dukshme, rezultatet e fundivitit treguan që angazhimi zinxhir i hallkave të institucionit në të gjitha nivelet dha rezultat pozitiv mbështetur në strategjitë e vendosura që në krye të herës, e në përputhje me objektivat e rrugët për të arritur ato.

Në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e arritura nga ASF përgjatë 2024 janë si më poshtë:

Administruam një portofol prej rreth 1.310 miliardë lekë. Në shifra kumulative përgjatë këtyre viteve iu është shërbyer rreth 38,099 klientëve, duke disbursuar rreth 8.9 mld Lekë.

Në mbyllje të vitit 2024, 53% e klientëve i përkisnin zonave rurale dhe 41% klientë femra.

ASF me rastin e festës së mësuesit dhe gruas, në datat 7 dhe 8 Marsit lançoi një produkt kredie promocional të dedikuar vetëm për individët e stafit pedagogjik, si dhe për çdo grua të interesuar për financim.

Një staf prej 94 punonjësish ishte në shërbim të 3,636 klientësh

Investimi në zhvillimin e vazhdueshëm/trajnime të stafit kanë qenë një prioritet gjatë vitit 2024. Edhe gjatë 2024-ës, ASF vazhdoi bashkëpunimin me Swisscontact dhe Partners Albania, mbi trajnimet, të cilat kishin në fokus teknikat e shitjes dhe sjelljen përkundrejt klientit.

Gjatë vitit 2024, në përmbajtje të planit të zgjerimit, ASF hapi nëndegën e Shkodrës duke shtrirë kështu shërbimin tonë edhe në këtë qytet dhe në zonat përreth.

Përgjatë 2024, ASF projektoi, testoi dhe vuri në shfrytëzim 2 sisteme shumë të rëndësishme lidhur me sigurinë e informacionit, si,: Sistemet e menaxhimit të pajisjeve fundore dhe Sistemet e menaxhimit të rrjetit kompjuterik; të cilat ofrojnë një gamë të gjerë suporti lidhur me sigurinë dhe sulmet kibernetike.

Gjithashtu përgjatë gjithë vitit vijoi ngritja e fondeve me partnerin KIVA si dhe në fund të vitit u nënshkrua një marrëveshje e re më Fondacionin Dorcas Aid International për projektin e titulluar "PËR NXITJEN E SIPËRMARRJES NË RAJONIN E TROPOJËS dhe PUKËS NËPËRMJET KREDITIMIT".

Përgjatë vitit 2024, ASF mori pjesë në Konferencën e organizuar nga MFC, e cila u mbajt në Krakow, ku gjatë së cilës u bë e mundur vendosja e kontakteve me disa lenders të mundshëm me të cilët ka vijuar shkëmbimi i informacioneve dhe pritet finalizimi i marrëveshjeve përgjatë vitit 2025. Gjithashtu u zhvilluan takime me partnerë aktualë, me të cilët u bisedua për zgjerimin e bashkëpunimeve, te cilat gjithashtu pritet të finalizohen përgjatë vitit 2025.

Tashmë e kthyer në një traditë, ASF mori pjesë në fushatën Borrow Wisely, fushatë kjo e iniciuar nga MFC, përgjatë gjithë muajit Tetor duke iu përshtatur risive që solli këtë vit sa i takon target grupit të përzgjdhur dhe gjithashtu përgjatë Konferencës së zhvilluar në Krakow, ASF ju akordua cmimi "Member Recognition Award" për pjesëmarrjen aktive në këtë fushatë.

SYNIMET DHE STRATEGJIA PËR VITIN 2025

Bazuar në projeksionet e ngritura në Biznes Planin e periudhës afatshkurtër për vitin 2025, ASF synon:

ASF deri në fund të vitit 2025 synon të ketë arritur në një portofol kredie me vlerë absolute prej 1.53 mld lekë dhe të ketë disbursuar kredi për rreth 3,400 klientë, me një shumë të disbursuar prej 1.1 mld lekë;

ASF do përdorë të gjithë burimet e veta, në formën më të mirë, për të mbajtur portofolin në risk në nivelin e parashikuar, ku PAR >30 jo më shumë 5% si dhe përmirësimin e instrumenteve për dedektimin dhe kontrollin e risqeve kyçe që kërcënojnë organizatën, duke përmirësuar cilësinë e dokumenteve të reja të implementuara brenda 2024-ës; si RAF apo Vintage Analyses dhe rritur ekspertizën, përdorimin e tyre dhe eficensën e vlerësimit të situatave dhe prognozave;

ASF deri në fund të vitit 2025 synon të zgjerojë shtrirjen dhe mbulimin me shërbime financiare në zona të tjera rurale e gjysmë urbane, nëpërmjet konsolidimit të degëve/zyrave ekzistuese, duke shndërruar zyrën e Shkodrës në degë rajonale, si dhe shtimit të një zyre të re (sub-branch);

ASF synon të përmirësojë ofertën e produkteve të saj nëpërmjet përmirësimit të produkteve, në koherencë me zhvillimet, duke projektuar oferta të përkohshme asociuar me sezone specifike dhe duke iu përshtatur nevojave të klientelës;

Në funksion të realizimit të synimeve mbi performancën dhe rritjen, ASF planifikon rritje të përqëndruar në degë të burimeve njerëzore me më shumë se 15%;

ASF përgjatë 2025, por e shtrirë për të mundur përmbylljen në periudhën afatmesme, do synojë të realizojë investime të qënësishme për garantimin e metejshëm të sigurisë e integritetit të të dhënave, rritjen e cilësise së punës me sistemin e informacionit dhe shërbesës ndaj rritjes së sigurisë kibernetike.

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2024

Crimson Finance Fund

CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA (CFFA)

Crimson Finance Fund Albania (CFFA) është një institucion financiar me një mision social për të rritur aksesin në financë për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, start-upet dhe aktivitetet që gjenerojnë vende të reja pune. CFFA kërkon të mbështesë këto grupe ndërmarrjesh me financime dhe këshillim financiar duke i ndihmuar të dalin nga « rrethi vicioz i të qendruarit të vegjël ». Me një gamë të gjerë produktesh si kredi me këste, qira financiare (leasing), linjë kredie dhe faktoring, CFFA synon të mbulojë nevojat e këtyre ndërmarrjeve në investime, kapital qarkullues, apo shtim dhe përmirësim të aseteve fikse.

Crimson Finance Fund Albania financon sektorin e manifakturës tre herë më shumë se mesatarja e tregut financiar në proporcion me portofolin e saj, si edhe i dedikon rreth 25% të disbursimeve të saj start-upeve, duke u bërë kështu një promotor dhe një derë e hapur për këto të fundit, të cilët përfitojnë përveç financimit edhe një konsulencë të personalizuar falas në lidhje me planin e tyre të biznesit dhe projeksionet financiare.

Viti 2024 ka shënuar një vit tjetër të suksesshëm për CFFA përsa i përket rritjes së portofolit dhe përmirësimit të cilësisë së tij. Përgjatë këtij viti CFFA, arriti të rrisë portofolin e tij me 39% (ose 47% pa konsideruar efektin e kursit te kembimit) krahasuar me vitin 2023, duke e cuar atë në 1.1 Miliardë Lekë. Niveli i disbursimeve u rrit gjithashtu ndjeshëm me 43% krahasuar me një vit më parë (720 Million Lekë), duke tejkaluar buxhetin e vendosur nga bordi drejtues. CFFA arriti gjithashtu të ulë nivelin e kredive me probleme në 3.7% në mbyllje të vitit 2024, si edhe të rrisë me 50% nivelin e te ardhurave si edhe fitimin krahasuar me një vit më parë.

Përgjatë vitit 2024, CFFA hapi degën e saj të dytë në nivel vendi, në qytetin e Elbasanit. Përmes kësaj dege CFFA pret të ketë një prezencë më të gjerë në këtë qytet dhe zonat perreth, për ti shërbyer shoqërive mikro dhe të vogla kryesisht në sektorët e manifakturës, bujqësisë dhe transportit.

Viti 2024 shënoi gjithashtu nje konsolidim të mëtejshëm të mardhënieve të CFFA me partnerë financiar vendas dhe të huaj si Banka Europiane e Investimeve, EBRD, dhe institucione të tjera financiare me mision zhvillimor, përmes takimeve të organizuara përgjatë gjithë vitit si edhe pjesëmarrjes në konferencen vjetore te MFC në Krakovë, Poloni.

CFFA publikoi gjithashtu Raportin e Impaktit per vitin 2024. Ky raport përmbledh 6 objektiva zhvillimor që CFFA ka në fokus: 1. Përfshirja financiare, 2. Aksesi në financë për start-upet, 3. Edukimi financiar dhe zbutja e informalitetit, 4. Barazia gjinore dhe krijimi i vendeve të punës, 5. Impakti social dhe mjedisor, 6. Shërbimi i sektorëve të pashërbyer.

CFFA synon të vazhdojë me vendosshmeri përmbushjen e misionit të ortakeve të saj përgjatë vitit 2025, duke u bërë një aktor i rëndësishëm në tregun financiar vendas me pozicionimin midis bankave dhe institucioneve të tjera financiare përsa i përket vlerës së financimit dhe kushteve të ofruara. CFFA do të vazhdojë të përqendrojë aktivitetin e saj në financimin e aseteve, aktiviteteve prodhuese dhe start-up-eve duke bashkëpunuar me institucione ndërkombëtare financiare që mbështesin financën sociale dhe synojnë rritjen e impaktit të hua-ve tona me qellim ngushtimin e hendekut të aksesit në financë për ndërmarrjet mikro dhe të vogla.

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2024

FED INVEST SHKK

Ecuria e përgjithshme e veprimtarisë dhe indikatorët kryesor

FED invest mbetet institucioni me i madh mikrofinanciar në Shqipëri me strukture kooperative, duke shërbyer 95,877 anëtare aktive ne fund te vitit 2024 përmes 59 degëve në të gjithë vendin. Numri i anëtareve u rrit me 4,505 gjatë vitit 2024 (+5%). Gjatë 32 viteve te funksionimit, mbi 250 mijë kredi janë akorduar dhe më shumë se 500 milionë euro janë injektuar në ekonomi.

Në vitin 2024 portofoli i kredisë arriti në 6.65 miliardë Lekë me një rritje vjetore prej 8.2%, ndërsa portofoli i depozitave u rrit ne 5.4 miliardë Lekë (+3%). Të ardhurat operacionale shënuan rritje prej 8.8%. Treguesi i NPL (kreditë me probleme) u mbajt në nivelin 6.1%, duke reflektuar një administrim te kujdesshëm te riskut.

Zhvillime dhe risi në shërbimet dhe produktet e ofruara

Gjatë vitit 2024 FED invest ka vijuar të divërsifikoi gamën e produkteve në funksion të nevojave të anëtarëve, duke forcuar rolin si ofrues i shërbimeve gjithëpërfshirëse financiare në zonat rurale dhe urbane. Janë zgjeruar shërbimet e pagesave utilitare në të gjitha degët, si dhe është intensifikuar përdorimi i llogarive rrjedhëse, overdrafteve dhe produkteve të personalizuara për SME-të dhe fermerët e konsoliduar.

Një vlerë e shtuar ka qenë integrimi i shërbimeve digjitale të pagesave dhe ofrimit të informacioneve financiare për anëtaret në kohë reale, si pjesë e përgatitjes për platformat Fintech që planifikohen të implementohen.

Zhvillime të brendshme, administrimi i rreziqeve dhe çështje HR

Gjatë vitit 2024 janë konsoliduar procedurat e riskut dhe kapacitetet njerëzore me fokus te menaxhimi i portofolit dhe monitorimi i riskut klimaterik dhe migrimit rural. Është modernizuar kuadri i politikave te brendshme lidhur me kreditë në sektorin bujqësor dhe SME. Kapacitetet institucionale janë forcuar përmes trajnimeve të stafit, ku 64% e punonjësve janë gra, duke kontribuar në barazinë gjinore dhe zhvillimin e personelit.

Ndikimi social dhe veprimtaritë ESG / Gender / Green

Si institucion me mision social, FED invest ka vazhduar të thellojë ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik rural. Përmes Qendrës ABA dhe platformës abaonline.al janë zhvilluar shërbime këshilluese dhe jo-financiare për fermerët dhe agrobizneset, me qellim ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe nxitjen e bujqësisë së qëndrueshme.

Instrumentet financiare janë kombinuar me mbështetje teknike për gra sipërmarrëse, ndërsa janë ndërmarre nisma të edukimit financiar për të rinjtë dhe familjet rurale. Financimi me fokus “green” në agrobiznes është rritur, pavarësisht sfidave të kushteve klimatike gjatë vitit.

Strategjia dhe plani i veprimit për vitin 2025

Duke u bazuar në vizionin e Institucionit për financa sa më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, gjatë vitit 2025 FED invest synon:

- Rritjen e anëtarësisë me objektiv arritjen e gurit kilometrik prej 100,000 anëtaresh
- Fuqizimin e kornizës së menaxhimit të riskut dhe përmirësimin e proceseve operative
- Përmirësimin dhe personalizimin e produkteve për SME dhe individët në zonat rurale dhe urbane
- Zgjerimin e investimeve në teknologji dhe inovacion në funksion të digjitalizimit të plotë të shërbimeve financiare dhe jo-financiare
- Rritjen e bashkëpunimeve me partnerët vendas dhe ndërkombëtare për mbështetje financiare dhe teknike në projekte zhvillimore dhe në promovimin e standardeve ESG.

Treguesit kryesorë 2024

Tregues	*Vlera*
Anëtarë	95,877
Degë	59
Fshatra të mbuluara	3,000
Staf total	316 (64% femra)
Totali i aktiveve	8.4 mld Leke
Mjaftueshmëria e kapitalit	21%
Portofoli i kredisë	6.65 mld Leke
Portofoli i depozitave	5.4 mld Leke
Yield kredive	14.3%
Yield depozitave	2.8%

Për më shumë informacion në lidhje me FED invest ju lutemi vizitoni faqen web https://www.fedinvest.al

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2024

FONDI BESA

Raporti Vjetor i Aktivitetit

Gjatë vitit 2024, Fondi Besa vazhdoi të forcojë pozicionin e tij në sektorin e mikrofinancës në Shqipëri. Me angazhimin për fuqizimin e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, Fondi Besa i shërbeu mijëra klientëve. Fokusi ynë në përfshirjen financiare ka një ndikim të konsiderueshëm në zonat urbane, gjysmë-urbane dhe rurale..

Arritjet Kryesore 2024

- Disbursimi i 8.2 miliardë lekë kredi, ose 2.74% më shumë se viti 2023, për 16,774 klientë, ose 13.09% më shumë klientë se viti 2023;
- Rritje e portofolit të kredisë në vlerën 14.8 miliardë lekë, ose 2.68% më shumë se viti 2023, me 27,498 klientë aktivë, ose 4.33% më shumë se viti 2023;
- Rritje e nivelit të kënaqësisë së klientëve në 90%;
- Zgjerimi i shërbimeve duke lançuar produktin e kredisë digjitale me aplikim online.

Misioni dhe Vizioni

Me një mision të fortë për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe për të reduktuar varfërinë, duke ofruar shërbime financiare të aksesueshme për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në të gjithë Shqipërinë, në zonat urbane dhe rurale, ne e shohim Shqipërinë si një vend ku çdo sipërmarrës ose fermer mikro dhe i vogël ka burimet për të realizuar ëndrrat e tij të biznesit dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës.

Përshtatja ndaj Ndryshimeve të Tregut

- **Produkte Kredie të Personalizuara:** Duke u bazuar në nevojat aktuale të klientëve, Fondi Besa përshtat produktet e kredisë për të reflektuar kushtet ekonomike ose ndryshimet në kërkesat e klientëve.
- **Zgjidhje Financiare Inovative:** Aftësia për të reaguar shpejt lejon Fondin Besa të prezantojë zgjidhje të reja financiare, si skemat fleksibël të ripagimit të kredisë, veçanërisht për aktivitetet sezonale, duke u përshtatur kështu me një gamë më të gjerë klientësh.

Burimet Njerëzore

- Në fund të vitit 2024, Fondi Besa numëron 629 punonjës, tregues i një fuqie të fortë punëtore, e cila është e domosdoshme për efektivitetin operativ të institucionit.
- Numri i stafit të degëve, rreth 72% e totalit, tregon fokusin e Fondit Besa në kontaktet direkt me klientin.
- 358 oficerë kredie, që përbëjnë 57% të stafit total, nënvizon faktin që institucioni ka rrënjë të forta në terren, me fokus tek shërbimi ndaj klientëve dhe tek zhvillimi i portofolit të qëndrueshëm të kredisë.
- Me 52% punonjës femra dhe 48% meshkuj, Fondi Besa tregon një shpërndarje gjinore të balancuar, duke reflektuar një kulturë pune gjithëpërfshirëse që mund të përmirësojë dinamiken e ekipit dhe performancën e përgjithshme.

Rëndësi të konsiderueshme Fondi Besa i jep trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të stafit për të përmirësuar aftësitë e tyre dhe për t'u përshtatur me ndryshimet e tregut.

Zgjerimi i Aktivitetit

- ***Afërsia me klientin:*** Në fund të vitit 2024, Fondi Besa operon me 77 zyra në të gjithë vendin. Fakti që synojmë të jemi pranë klientëve, duke krijuar një prezencë të fortë në Shqipëri dhe t'i përgjigjemi nevojave të tyre financiare në kohë reale reflekton një objektiv strategjik që nënvizon afërsinë ndaj klientit dhe rëndësinë e shërbimit të shpejtë në procesin e dhënies së kredive.
- ***Përgjigja e kërkesave për kredi në kohë reale:*** Për këtë, ne përmirësojmë vazhdimisht sistemet e përpunimit të kredive, duke përdorur teknologji që lejon shqyrtimin dhe miratimin e aplikimeve në mënyrë të shpejtë.
- ***Përdorimi i platformave digjitale:*** Integrimi i platformave digjitale lehtëson komunikimin e menjëhershëm midis klientëve dhe oficerëve të kredisë, duke bërë procesin e huadhënies më efikas.
- ***Mekanizmat e feedback-ut:*** Studimet e kënaqësisë së klientëve mbi shërbimet dhe produktet, lejojnë Fondin Besa të bëjë përmirësime dhe të sigurojë që ofertat tona përputhen me kërkesat e klientëve. Ne kujdesemi që klientët të ndihen të inkurajuar të shprehin nevojat ose shqetësimet e tyre, duke rezultuar në një shërbim më të përgjegjshëm.
- ***Ndërtimi i marrëdhënieve afatgjata me klientët:*** Në vend që të jetë një ofrues i thjeshtë shërbimesh financiare, Fondi Besa pozicionohet si partner financiar në rritjen dhe suksesin e klientëve.
- ***Besimi dhe Besnikëria:*** Mbështetja e vazhdueshme dhe përvoja pozitive e klientit mund të rrisë besimin e tyre ndaj institucionit. Klientët ka më shumë gjasa të kthehen për kredi shtesë ose të rekomandojnë Fondin Besa, kur ndihen që nevojat e tyre unike janë përmbushur në kohë.

Objektivat Strategjike të Fondit Besa

Gjatë tre viteve të ardhshme, huadhënia do të mbetet fokusi kryesor për Fondin Besa, me theks të veçantë në tregun e mikrofinancës në Shqipëri.

- Aktiviteti pritet të rritet gradualisht, duke arritur në një portofol rreth 20 miliardë lekë deri në fund të vitit 2027.
- Numri i klientëve aktivë pritet të arrijë 40,000 deri në fund të vitit 2027.
- Synohet rritja e produktivitetit dhe efikasitetit të stafit përmes trajnimeve dhe proceseve që do të optimizojnë performancën e punonjësve.
- Do të punohet për diversifikimin më tej të gamës së produkteve dhe shërbimeve për të përmbushur kërkesat e ndryshme të tregut.

IUTE ALBANIA

IuteCredit Albania sh.a u themelua në vitin 2014 dhe nisi aktivitetin në prill 2015. Është e licencuar nga Banka e Shqipërisë si një institucion mikrofinanciar jobankar (licenca nr. 32, datë 31.03.2015) dhe është në pronësi të plotë të Iute Group AS, një kompani estoneze që emeton obligacione në Bursën e Frankfurtit dhe Nasdaq Tallinn.

Kompania ofron kredi konsumatore pa kolateral, me afate shlyerjeje deri në 48 muaj, dhe operon përmes një rrjeti të gjerë partnerësh tregtarë në të gjithë vendin. Qëllimi kryesor është të ofrojë shërbime financiare të thjeshta, të shpejta dhe plotësisht digjitale, të përshtatura sipas nevojave të klientëve shqiptarë

Misioni dhe Vizioni

- Misioni: Të krijojmë përvojën më të mirë për financat personale, duke kombinuar teknologjinë financiare me të vepruarit njerëzor. Të ndihmojmë klientët tanë të bëhen financiarisht dhe teknologjikisht më të fortë.
- Vizioni: Një e ardhme ku njerëzit përdorin shërbimet financiare menjëherë, me besim dhe në mënyrë të pavarur, dhe kthehen në Iute falë përvojës së jashtëzakonshme.

Zhvillime kyçe gjatë 2024

Viti 2024 shënoi një vit rritjeje të qëndrueshme dhe ekselence operacionale për IuteCredit Albania.

- Gjatë vitit, kompania shërbeu gjithsej 122,606 kredi, prej të cilave mbi 63,000 ishin "Bli Tani Paguaj Më Vonë (BNPL)", duke reflektuar rritjen e kërkesës për financim fleksibël në pikën e shitjes.
- 96.8% e kontratave u nënshkruan elektronikisht, duke treguar fokusin e vazhdueshëm të kompanisë tek efikasiteti digjital dhe autonomia e klientit.
- Përmes një rrjeti kombëtar me mbi 1,600 partnerë tregtarë dhe më shumë se 2,300 pika aktive shitjeje, IuteCredit Albania zgjeron praninë e saj në çdo rajon të vendit.
- Ndërkohë që funksionalitetet e ATM-ve dhe pagesave u zhvilluan në bashkëpunim me IutePay Albania, fokusi kryesor mbeti përmirësimi i përvojës së kredisë dhe ndërtimi i marrëdhënieve më të thella me klientët.

Performanca Operacionale & Financiare

IuteCredit Albania vazhdoi të digjitalizojë të gjithë ciklin e kredisë, nga aplikimi te miratimi, përmes automatizimit, analizës së të dhënave dhe mjeteve të vetëshërbimit. Këto përpjekje kontribuan në një proces më të thjeshtuar huadhënieje dhe ulje të kostove operacionale.

- Kompania ruajti një strukturë efikase me 132 punonjës, të mbështetur nga operacione të fuqishme të kujdesit ndaj klientit, të cilat trajtuan mbi 4.4 milionë ndërveprime përmes telefonit, chat-it, email-it dhe platformave të mesazheve.
- Kënaqësia e klientëve mbeti e lartë, me një Net Promoter Score (NPS) mbi 85.
- Në vitin 2024, totali i aktiveve u rrit me 14% krahasuar me vitin 2023 (pas një rritjeje prej 7% në 2023 krahasuar me 2022).
- Të ardhurat totale mbetën të qëndrueshme me një rritje të lehtë prej 1%, ndërsa fitimi neto, edhe pse më i ulët se një vit më parë, mbeti pozitiv në 4.7 milionë euro.
- Fondet e huamarrjes për të ruajtur likuiditetin janë pjesë standarde e strategjisë financiare të kompanisë, të siguruara nga tregjet vendase dhe ndërkombëtare.
- Normat e interesit për huamarrjet ndërkombëtare mbetën të pandryshuara krahasuar me 2023, ndërsa u regjistrua një ulje e lehtë e normave të interesit në huamarrjet vendore, duke treguar besimin e tregut tek institucionet financiare jobankare.
- Kjo situatë favorizuese i mundësoi kompanisë të rrisë huamarrjet vendore me kosto më të ulët, duke reflektuar përfitimin te klientët përmes ofertave më konkurruese të kredisë.
- Veçanërisht, në vitin 2024, kompania siguroi një linjë të re krediti nga Union Bank me vlerë pothuajse 2 milionë euro.
- Portofoli neto i kredive u rrit me 15% në krahasim me një vit më parë, i nxitur nga kërkesa e qëndrueshme dhe menaxhimi efikas i kredisë.
- Cilësia e kredisë mbeti e fortë, me raportin e huave me probleme (NPL) që u përmirësua në 9.4% deri në fund të vitit 2024, nga 10.6% në fund të vitit 2023.

Përgjegjësia Sociale

Në vitin 2024, IuteCredit Albania thelloi ndikimin e saj në arsim, përfshirje sociale dhe angazhimin me komunitetin:

- IUTECH: një platformë e dedikuar për digjitalizimin, edukimin financiar dhe fuqizimin teknologjik. Prezantuar gjatë *Global Entrepreneurship Week*, IUTECH synon të ndërthurë financën tradicionale me zgjidhjet moderne fintech. Bashkëpunimi i parë institucional u arrit me Tirana Western Balkan University, duke shënuar fillimin e një misioni më të gjerë për të mbështetur aftësitë digjitale, aksesin financiar dhe inovacionin në Shqipëri. Nëpërmjet platformës IUTECH, ne u bashkuam me *Startup Albania* gjatë *Global Entrepreneurship Week*, duke ftuar Martin Ruubel, një ekspert i njohur në digjitalizim, për të marrë pjesë në konferenca dhe diskutime mbi inovacionin, sipërmarrjen dhe të ardhmen e shërbimeve financiare.
- Fuqizimi i grave: Fushata *"E Zonja Vetes"*, e udhëhequr nga kampionia olimpike Luiza Gega, promovoi pavarësinë financiare për gratë në Shqipëri.
- Shëndeti dhe sporti: Përmes nismës *"Ti nuk vrapon vetëm"*, nxitëm stilin aktiv të jetesës dhe mbështetëm maratonat qytetare në Kamëz dhe Vlorë.
- Përfshirja sociale: Në partneritet me *Down Syndrome Albania*, kompania mbështeti aktivitete komunitare gjatë sezonit të festave.
- Dhuro gjak: Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, stafi i Iute mori pjesë vullnetarisht në aksione për dhurim gjaku.
- Formimi i të rinjve: U dhanë 16 bursa për të rinjtë në teknologji, në bashkëpunim me *SDA Protic Albania* dhe *American Development Foundation*.
- Ekosistemi i startup-eve: Mbështetëm sipërmarrësit në fazat e hershme përmes eventit *"Get in the Ring Albania"*.

Kredo.al

KREDO FINANCË

Viti 2024 ishte një vit i jashtëzakonshëm për Kredo.al. Njohja e markës sonë arriti nivele të reja, ndërsa planet dhe iniciativat tona patën një ndikim të madh në sektorin e mikrofinancës ashtu si edhe u munduam që të sillnim një impakt pozitiv dhe në ato komunitete të cilat nuk shërbehen nga ne por që kanë kaq shumë nevojë për ndihmë. Në vitin 2025, synojmë të çojmë këtë sukses edhe më tej, me një fokus të veçantë në inovacionin teknologjik dhe dixhitalizimin e shërbimeve tona.

Ecuria e përgjithshme e veprimtarisë dhe indikatorët kryesorë

Gjatë vitit 2024, Kredo.al tregoi një rritje të qëndrueshme dhe performancë të fortë pavarësisht sfidave në treg. Disa nga indikatorët kryesorë përfshijnë:

- 180,000 aplikime të pranuara
- 133,000 kredi të dhëna
- 84% klientë të përsëritur
- 57 milion euro të akorduara në kredi
- 77% e portofolit përbëhet nga kredi të përsëritura

Kompania operon në 38 degë dhe ka 230 punonjës, duke ruajtur stabilitet në numrin e stafit dhe zgjeruar ndjeshëm penetrimin në treg.

Zhvillime dhe risi në shërbimet/produktet tona

Finalizimi i integrimit me EvroTrust për identifikim dhe firmosje dixhitale –kredidhënie 100% online.

- Automatizim i proceseve dhe përmirësim teknologjik në të gjitha hallkat e operimit.
- Oferta për klientët besnikë dhe të rinj, duke përfshirë "Kredinë e Parë Falas".

Zhvillime në politikat e brendshme, administrimi i rreziqeve, HR

- Forcim i sistemit të kontrollit të brendshëm, auditimit të brendshëm dhe përputhshmërisë me kuadrin rregullator.
- Certifikim ISO 27001 për sigurinë e informacionit dhe implementim i parimit të "zero besimit" për akseset në sistemet TIK.
- Trajnime të vazhdueshme për zhvillim profesional dhe akademia e liderëve për drejtuesit e rinj.
- Pjesëmarrje aktive në panaire punësimi dhe bashkëpunime me universitete si pjesë e strategjisë së rekrutimit.

Ndikimi social dhe aktivitetet e zhvilluara për këtë qëllim

Gjatë vitit 2024, Kredo.al ka treguar një përkushtim të palëkundur ndaj zhvillimit të komunitetit përmes një sërë nismash me ndikim në të gjithë Shqipërinë. Këto përpjekje përfshijnë mbështetje për grupet e margjinalizuara, përmirësime në fushën e arsimit dhe kontribute në shëndetësi, duke reflektuar përgjegjësinë sociale të kompanisë.

Fuqizimi Ekonomik i Grave të Margjinalizuara dhe të Mbijetuarave të Dhunës në Familje

Kredo.al ka financuar një projekt që synon fuqizimin e grave dhe vajzave të margjinalizuara, përfshirë të mbijetuarat e dhunës në familje, në bashkitë e Tiranës dhe Elbasanit.

Stafi i Kredo.al Sjell buzëqeshje për Grupet e Margjinalizuara

Gjatë muajve dhjetor dhe janar, stafi i përkushtuar i Kredo.al organizoi një iniciativë zemërgjerë për të ndihmuar komunitetin.

Bashkëpunimi me Fshatin SOS për Mbështetje të Rinjve Jetimë

Në partneritet me SOS Fshatin, Kredo.al sponsorizoi kurse profesionale tre mujore për të rinjtë jetimë që banojnë në këtë fshat.

Zhvillimi i Komunitetit përmes Donacioneve Domethënëse

Mbështetje për zhvillimin e mëtejshëm intelektual të fëmijëve të të gjitha moshave në këto komunitete.

Dhënia e Pajisjeve Kompjuterike për Shkollën "Teknike Elektrike Gjergj Canco"

Mbështetje për Familjet në Nevojë

Stafi i Kredo.al mori pjesë aktivisht në një fushatë të organizuar nga World Vision Albania dhe Banka e Ushqimit, duke dhuruar ushqime për të mbështetur familjet në nevojë.

Mbështetje për Kampin Veror Tropojë 2024

Kredo.al luajti një rol të rëndësishëm si sponsor kryesor për Kampin Veror dhe Projektin e Shërbimit Komunitar, të mbajtur në Bajram Curri, Tropojë, gjatë korrikut 2024. Kampi ofroi aktivitete edukative për fëmijë të moshës 7 deri në 13 vjeç, duke promovuar punën në ekip, ndërgjegjësimin mjedisor dhe jetesën e shëndetshme.

Dhurim Gjaku për Pacientët me Talasemi

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2024

MIA FINANCE

MiA Finance sh.a është një institucion mikrofinanciar jobankë, i themeluar në vitin 2007, me kapital 100% shqiptar, i liçensuar nga Banka e Shqipërisë në vitin 2010 për veprimtari mikrokredie. MiA finance kryen shërbime në 10 degë të shpërndara në të gjithë Shqipërinë.

MiA Finance sh.a synon që të vazhdojë të përmirësojë dhe konsolidojë imazhin e saj nëpërmjet punës së pandëprerë të stafit profesional, duke patur gjithmonë parasysh parime të padiskutueshme si cilësia, transparenca dhe fleksibiliteti ndaj klientëve dhe duke i trajtuar klientët në mënyrë të barabartë, pavarësisht kushteve personale, sociale apo demografike. Besueshmëria e klientëve është prioriteti ynë dhe na shtyn që të punojmë akoma më fort për të arritur një pozitë të favorshme në treg si institucioni më i besueshëm financiar, me një etikë të lartë profesionale. MiA Finance ofron produkte financiare për të gjitha llojet e klientëve. Grupet e synuara janë bizneset e vogla e të mesme dhe agrobizneset.

Gjatë vitit 2024 MiA finance realizoi një investim madhor në sistemet e brendshme të institucionit të cilat përfundimisht u aktivizuan LIVE në 1 Prill 2024. Ky investim solli përmirësim dhe automatizim të proceseve, ulje të kohës së procesimit në kredidhënie, akses të menjëhershëm në të gjithë databazën e të dhënave nëpërmjet moduleve specifike për klientët, kredinë, pagesat, finance si dhe nivel të lartë sigurie për mbrojtjen e të dhënave të klientit dhe databazën.

Momentet kryesore 2024

Hyrja në zyrat e reja Head Office të MiA finance tek rruga Abdyl Frashëri Sheshi Willson.

Degët e reja të hapura:

Dega Shkodër – 01 Shkurt 2024

Dega Tiranë 3 – 07 Nëntor 2024

Numri total i të punësuarve (Dhjetor 2024): 76 – Prej tyre, 49 janë femra

Trajnime të zhvilluara gjatë vitit 2024

Muaji	Numri i Trajnimeve	Përshkrimi
Janar	1	"Ligji i Trajnimit mbi të Ardhurat"
Shkurt	1	"ASPEKT Product Suite v.4.0"
Mars	2	"Implementimi i sistemit ASPEKT" (1 për specialistët, 1 për arkëtarët)
Prill	2	"Sistemi ASPEKT";
		"Kreditë dhe Menaxhimi i Informacionit në Bizneset Mikro"
Maj	2	"Trajnim nga CBS Team". "Procedurat Blic dhe Blic Plus"
Korrik	1	"Procedurat e Kredidhënies"
Gusht	1	"Procedurat e Kredidhënies dhe Analiza Financiare"
Nëntor	2	"Procedurat e Kredidhënies dhe Analiza Financiare";
		"Kreditë Agro Biznes dhe njohuritë mbi to"

Aktivitet me ndikim social

- Aktivitet sensibilizues (1 Qershor 2024): Vizitë në Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli" me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve. U shpërndanë dhurata për fëmijët dhe u zhvillua një aktivitet simbolik në shenjë solidarizimi.
- E "premtja verore" për stafin e MiA finance

Në vijim të përkushtimit tonë për të krijuar një mjedis pune sa më pozitiv dhe për të nxitur një ekuilibër të shëndetshëm mes jetës dhe punës, MiA finance sjell nismën e re "Te premtet Verore". Të premtet verore do të zgjasin për një periudhë 3 mujore (Qershor-Gusht), ku dita e punës do të përfundojë në orën 14:30 për të gjithë stafin e Head Office.

Aktivitete gjatë 2024:

- Aktivitet me stafin e punonjësve femra të Mia Finance për 8 Mars, ditën e gruas në ambjentet e head office.
- Aktiviteti për ditën e Tokës me datë 22 Prill. Në bashkëpunim me APR Tirana për fushatën "Dhuro një pemë" Mia finance mbolli 8 pemë të reja në Parkun e Madh Artificial të Tiranës.
- Panairi i Punës tek Fakultetit Ekonomik i Tiranës.
- panairi "Ditët e Bujqësisë" në qytetin e Lushnjes 24-26 Prill, MiA finance pjesëmarrëse për herë të parë.
- Aktivitetit "Prespa Fest" në Pustec,Korçë në 7 Maj.
- Panairi i Punës dhe Karrierës në Durrës.
- Dita e turizmit-bio "Funarfest" në Elbasan në 20 Maj.

NOA

Hyrje

Viti 2024, shënoi 25-vjetorin e themelimit të NOA-s, duke festuar një çerek shekulli përkushtimi, besimi dhe ndikimi në fuqizimin e sipërmarrësve, fermerëve dhe familjeve shqiptare. Gjatë këtyre 25 viteve, NOA ka ndërthurur ekspertizën financiare, risitë dhe një qasje të orientuar drejt klientit, duke u pozicionuar si një partner i besueshëm për rritjen ekonomike dhe zhvillimin shoqëror. Për të kremtuar këtë arritje, NOA ndërmori fushatën kombëtare #RrënjëtEVendlindjes, një nismë që solli në vëmendje kontributin e saj në komunitetet lokale, në sipërmarrje dhe në zhvillim të qëndrueshëm.

Zhvillimet Strategjike: Ndryshim Aksioneri

Ngjarja më përcaktuese e vitit 2024 ishte blerja e NOA-s nga Tranzit shpk, aksionari i vetëm i ABI Bank. E miratuar nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Konkurrencës, kjo marrëveshje strategjike forcon themelet e NOA-s dhe krijon mundësi të reja bashkëpunimi me Bankën ABI duke zgjeruar gamën e produkteve dhe shërbimeve dedikuar klientëve të saj. Nën këtë pronësi të re, NOA do të konsolidojë më tej angazhimin e saj ndaj markës së ndërtuar ndër vite, misionit të saj si Financë Njerëzore dhe rolit si partner i besuar për komunitetet në mbarë vendin.

Performanca Financiare dhe Ndikimi tek Klientët

Në vitin 2024, portofoli aktiv i kredidhënies në NOA arriti në 111.3 milionë euro, duke reflektuar një rritje vjetore prej 21.3%. Ky rezultat pasqyron aftësinë e institucionit për të ruajtur vazhdimësinë dhe përkushtimin në shërbimin ndaj segmenteve prioritare, duke kombinuar zgjidhje inovative dhe të aksesueshme me kapacitete më të forta shërbimi dhe me një angazhim gjithnjë e më të madh ndaj klientëve.

Megjithëse kosto e fondeve u rrit me 7% krahasuar me vitin 2023, NOA arriti ta zbusë këtë sfidë përmes ekonomisë së shkallës në teknologji, operacione dhe mbajtjen e cilësisë së portofolit. Në vend që të kufizonin aktivitetin, ato shërbyen si nxitje për përmirësim shërbimi dhe rritje të efikasitetit në procese. Kjo qëndrueshmëri pasqyrohet gjithashtu në stabilitetin e portofolit, me nivelin e kredive me probleme NPL në 2.7%, duke nënvizuar cilësinë e kredidhënies dhe besimin e klientëve.

Arritje dhe Inovacione

Viti 2024 u dallua gjithashtu nga një sërë arritjesh dhe risish:

- Hapja e Degës Digjitale – prezantimi i një procesi kredidhënieje plotësisht online, përfshirë regjistrimin elektronik të klientëve (KYC digjital) dhe nënshkrimin elektronik të kontratave, duke ofruar akses më të shpejtë dhe më të thjeshtë.
- Zgjerimi i Kanalit BPN – zhvillimi i produkteve B2B dhe partneriteteve, përfshirë skemat e financimit "Bli tani – paguaj më vonë".
- Bashkëpunime Ndërkombëtare – pjesëmarrje aktive në programin Erasmus for Young Entrepreneurs (EYE), i cili u mundësoi 29 sipërmarrësve të rinj shqiptarë dhe 16 profesionistëve të fitojnë përvojë të vlefshme në Evropë.
- Vlerësime dhe Çmime – fitues i çmimit prestigjioz SDG Business Pioneers Award nga Zyra e OKB-së në Shqipëri, duke e renditur NOA-n ndër kompanitë më të dalluara në fushën e ESG dhe CSR në nivel kombëtar. Një tjetër arritje e rëndësishme ishte vlerësimi pozitiv i marrë nga ConsciESG, i cili theksoi edhe një herë rolin udhëheqës të NOA-s në financat e qëndrueshme dhe të përgjegjshme.
- Angazhim në Komunitet dhe Kulturë – përtej festimeve të 25-vjetorit, NOA vijoi mbështetjen e programeve sociale, donacioneve dhe nismave kulturore, duke forcuar identitetin e saj si një partner i përkushtuar ndaj komunitetit.

Një Vit që përcakton rrugëtimin tonë

Arritjet e vitit 2024, nga festimet e 25-vjetorit dhe fushata #RrënjëtEVendlindjes, te inovacionet digjitale dhe vlerësimet në fushën e ESG, pasqyrojnë qëndrueshmërinë, përshtatshmërinë dhe angazhimin e vazhdueshëm të NOA-s ndaj klientëve dhe komunitetit. Me një trashëgimi të fortë në shërbimet financiare, një strategji të orientuar drejt së ardhmes dhe mbështetjen e aksionarëve të rinj, NOA është e pozicionuar në mënyrë të shkëlqyer për të vijuar me nxitjen e përfshirjes financiare, rritjes ekonomike dhe ndikimit pozitiv shoqëror në mbarë Shqipërinë.





UNIFIN SHKK

Ecuria e përgjithshme e veprimtarisë dhe indikatorët kryesorë

Viti 2024 shënoi një tjetër etapë të suksesshme për Shoqatën e Kursim-Kreditit UNIFIN, duke përforcuar tendencën pozitive të viteve të fundit. Treguesit financiarë dhe operacionalë reflektuan një rritje të qëndrueshme, efikasitet në menaxhim dhe përmirësim të qëndrueshmërisë institucionale.

- Totali i aktiveve arriti në 1.52 miliard lekë, duke reflektuar një rritje prej 9.94% në krahasim me fundin e vitit 2023.
- Kapitali i Shoqatës u rrit me 9.54%, duke rritur fuqinë financiare dhe kapacitetin për financim të mëtejshëm.
- Portofoli i kredisë bruto u zgjerua ndjeshëm, duke arritur 1.417 miliard lekë, me një rritje vjetore prej 19.77%.
- Depozitat e anëtarëve u rritën në 1.240 miliard lekë, me një ritëm prej 16.85%, si rezultat i fushatave të mirëorganizuara për thithjen e fondeve dhe besimit në shërbimet e SHKK-së.
- Anëtarësia arriti në 21,800 persona, me 870 anëtarë të rinj, duke konfirmuar besueshmërinëe SHKK-se në komunitet.

Këta tregues jo vetëm që konfirmojnë rritjen, por tregojnë për një menaxhim të kujdesshëm dhe afatgjatë të burimeve financiare dhe rreziqeve të lidhura me aktivitetin e SHKK-se.

Zhvillime dhe risi në shërbimet / produktet e ofruara dhe modelin e biznesit

Gjatë vitit 2024, SHKK UNIFIN ka vijuar angazhimin e saj në përmirësimin e ofertës së produkteve financiare, me synimin për të qenë sa më pranë nevojave reale të anëtarëve dhe për të ruajtur konkurrueshmërinë në treg.

Depozitat

Janë dizajnuar dhe promovuar produkte të reja depozitash, të cilat u orientuan drejt grupeve të veçanta si mësuesit dhe gratë – si: "7-8 Mars", "Për ty Mësues", "Ti Vlen", "Anëtar Besnik".

Është shtuar në buletinin e ofertave edhe depozita me afat 6-mujor, për të ofruar më shumë fleksibilitet.

Produktet e kredisë

U realizua një rishikim i normave të interesit dhe komisioneve për produktet e kredisë, me qëllim një qasje më të drejtë dhe më të afërt me tregun, si dhe për të rritur transparencën ndaj anëtarëve.

Marketing dhe komunikim

U fuqizua prania në rrjetet sociale, me fokus në promovimin e produkteve dhe informimin e anëtarëve në kohë reale.

U zhvillua një fushatë efektive për rritjen e depozitave në periudhën Mars–Maj, duke përfshirë edhe incentiva të drejtpërdrejta për stafin, që rezultuan në një rritje të ndjeshme të likuiditetit.

Zgjerimi gjeografik

U hap zyra e re në qytetin e Lezhës, duke zgjeruar më tej shtrirjen e SHKK-së në veri të vendit dhe duke përforcuar misionin për shërbim të barabartë në të gjitha zonat.

Politikat e brendshme, administrimi i rreziqeve dhe zhvillimet në fushën e burimeve njerëzore

Menaxhimi i rrezikut

Risku i kredisë (NPL) ka ardhur në rënie relative pavarësisht rritjes në vlerë absolute të kredive problematike. Nga 2.78% në vitin 2023, NPL ra në 2.6% në 2024, çka dëshmon një menaxhim efektiv të portofolit.

Këshilli Drejtues nuk ka ndërmarrë fshirje kredish, një tregues i besimit në rikuperimin e huave.

Administrimi dhe HR

Vazhdoi analiza e performancës së degëve, duke vlerësuar veçanërisht pesë degët më të suksesshme për vitin 2024: Tiranë, Shkodër, Laç, Pogradec, Divjakë.

Janë aplikuar praktika motivuese për stafin, sidomos gjatë fushatave për rritjen e depozitave – duke nxitur performancën dhe ndjenjën e përfshirjes.

Ndikimi social dhe veprimtaritë me fokus ESG, barazi gjinore, përfshirje financiare

SHKK UNIFIN, edhe pse në mënyrë të tërthortë, ka përfshirë disa aspekte me ndikim social dhe ekonomik që i afrohen standardeve të qëndrueshmërisë (ESG):

Përmes produkteve të tilla si "7-8 Mars" dhe "Për ty Mësues", është synuar mbështetja dhe fuqizimi ekonomik i grave dhe mësuesve, grupe shpesh të nënpërfaqësuara në kreditim.

Me hapjen e degës në Lezhë, është rritur përfshirja financiare në zona më pak të mbuluara, duke mundësuar akses më të lehtë në shërbimet financiare.

Rritja e transparencës, edukimit financiar dhe komunikimit digjital po kontribuon në ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen më të mirë të anëtarëve.

Shkk UniFin synon që në të ardhmen, organizata të përfshijë më qartë politika dhe tregues të lidhur me ESG, si: mjedisi, barazia gjinore, financimi i qëndrueshëm, etj.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për vitin 2025

SHKK UNIFIN ka përgatitur një plan ambicioz për vitin 2025, i fokusuar në zgjerim, inovacion dhe qëndrueshmëri:

Rritje e mëtejshme e portofolit të kredive në nivelin 1.7 miliard lekë, duke ruajtur cilësinë e huave.

Sigurimi i fondeve të reja, për të mbështetur zgjerimin dhe për të përballuar nevojat e tregut.

Hartimi i një strategjie afatmesme për digjitalizimin e shërbimeve dhe produkteve – hap drejt modernizimit dhe automatizimit të proceseve.

Zgjerimi i gamës së produkteve, për të përfshirë shërbime të reja për anëtarët përtej kredive dhe depozitave – me synim diversifikimin e të ardhurave dhe rritjen e bazës së klientëve.

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2024

9 PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË SHOQATËS GJATË VITIT 2024

MBLEDHJE DHE TAKIME

1 Qershor 2024, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare njofton riemërimin e znj. Brunilda Isaj në postin e Sekretarit te Përgjithshëm të saj. Znj. Isaj ka kontribuar në këtë pozicion në të shkuarën për një periudhë rreth 4 vjecare (2019 - 2023) dhe rikthehet për të marrë sërish këtë detyrë .

19 Dhjetor 2024, AMA zhvilloi takimin e fundvitit për të diskutuar dhe miratuar Strategjinë dhe Plan-Buxhetin 2025 . Takimi i fundvitit u përmbyll me një darkë festive , ku morën pjesë drejtues ekzekutivë dhe menaxherë të lartë të institucioneve anëtare të Shoqatës, si dhe të ftuar të veçantë nga Banka e Shqipërisë.

Presidentja e Mikrofinanca Shqiptare, znj. Arlinda Muja, falenderoi të gjithë Anëtarët për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre për arritjen e objektivave të shoqatës për gjatë vitit 2024

KONFERENCA DHE EVENTE

5 Shkurt 2024, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mbajti një takim me gazetarë të ekonomisë dhe përfaqësues të mediave në vend, për të përcjellë informacion në lidhje me veprimtarinë e sektorit gjatë vitit 2023, si edhe planet dhe pritshmëritë për të ardhmen.

Gjatë takimit u parashtruan sfidat e ekonomisë shqiptare të parë nga këndvështrimi i individëve, roli i mikrofinancës në nxitjen e ekonomisë vendase dhe rëndësia thelbësore e këtyre intitucioneve në zhvillimin teknologjik të sektorit financiar dhe edukimin financiar të individëve të shërbyer. Ndërsa Shqipëria kalon nëpër sfidat ekonomike, sektori i mikrofinancës shfaqet si një fener shprese, duke ofruar mbështetje thelbësore financiare për qytetarët që e shohin veten të pashërbyer nga institucionet tradicionale bankare. Shoqata Mikrofinanca Shqiptare thekson rolin kryesor që luan mikrofinanca në forcimin e ekonomisë së vendit, nxitjen e përfshirjes financiare dhe fuqizimin e individëve gjatë këtyre kohërave të pasigurta.



21 Mars 2024, në eventin "E ardhmja e FinTech" Mikrofinanca Shqiptare ishte pjesë e panelit "Financimi i së ardhmes: Rritja e teknologjive të qëndrueshme financiare, përfaqësuar nga Zj. Arlinda Muja, Presidente e Shoqata Mikrofinanca Shqiptare dhe njëkohësisht CEO e Kredo Finance dhe Zj. Herjola Spahiu, CEO e NOA

Financimi i qëndrueshëm ka të bëjë me krijimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme për të gjithë. Ka të bëjë me integrimin e ESG (aspektet mjedisore, sociale dhe qeverisjen), në të gjitha aspektet e vendimmarrjes financiare. Kjo do të thotë të analizosh performancën e ESG të një kompanie, të angazhohesh me kompaninë për të promovuar praktika më të mira dhe të votosh propozimet e aksionarëve në lidhje me çështjet e ESKëto mesazhe u përcollën në këtë event kushtuar Fintech, Inovacionit dhe kompanive të përgjegjshme.

6-9 Nëntor 2024, Mikrofinanca Shqiptare është pjesëmarrëse në panairin e KLIK EKSPO GROUP & Tirana International Fair. Ne ditën e dytë të KLIK EKSPO GROUP & Tirana International Fair, sekretarja e përgjithshme e Mikrofinanca Shqiptare znj.Brunilda Isaj, z.Akan Ajdini Drejtor i Pergjithshem ekzekutiv i Iute Albania dhe znj.Suela Coka drejtor i departamentit të kredisë SHKK Unifin do të jenë pjesë e panelit dedikuar sektorit financiar në Shqipëri me temë :

"Sfidat e Digjitalizimit", ku do të diskutohet mbi kuadrin rregullativ dhe forcimi i bashkëpunimit midis aktorëve të tregut.

TRAJNIME DHE WORKSHOPS

24 Janar 2024, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare organizoi trajnimin informues për Ligjin nr 29.2023, Tatimin mbi të Ardhurat.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin drejtuesit e departamenteve të financës dhe burime njerëzore nga institucionet anëtare të AMA. Trajnimi u drejtua nga konsulenti tatimor, z. Fatmir Kazazi.

Ligji i ri është i përbërë nga dy kapituj kryesorë:

1. Pjesa e parë që trajton "Tatimin mbi të Ardhurat Personale".

Në këtë pjesë të ligjit trajtohen te ardhurat personale, përfshirë këtu ndryshimet kryesore lidhur me të ardhurat nga punësimi si dhe kategorizimi i ri për personat fizik tregtarë. Në këtë pjesë trajtohen kryesisht çështje që lidhen me listëpagesën, deklaratën individuale vjetore të të ardhurave, ndryshimet lidhur me pensionet private si dhe risitë e ligjit për trashëgiminë dhe dhurimin.

2. Pjesa e dytë qe trajton "Tatimin mbi te ardhurat e korporates (tatim fitimi)".

Në këtë pjesë të ligjit trajtohen dispozitat që lidhen me tatim fitimin, duke përfshirë ndryshimet lidhur me amortizimin, interesat e zbritshme, shpenzimet e panjohura, mbartjen e humbjeve dhe nenin e tatimit ne burim i cili ka një ndryshim rrënjësor dhe është me shume interes për trajtim dhe diskutime.

Trajnimi ishte interaktiv me pyetje, dikutime dhe problematika që impaktojnë sektorin e mikrofinancës në lidhje me udhëzimin e ri.

5-6 Dhjetor 2024, Mikrofinanca Shqiptare në bashkëpunim me UNHCR, Albania organizuan në datat 5-6 dhjetor 2024 një seminar dyditor trajnues me temë: Menaxhimi i financave personale të refugjatëve dhe #azilkërkuesve.

Synimi i këtij trajnimi ishte ndërtimi i aftësive financiare të refugjatëve dhe azilkërkuesve me qëllim përmirësimin e edukimit dhe përfshirjes financiare të popullatës refugjate dhe azilkërkuese.

Nga ana e Shoqatës në event u prezantuan mundësitë për sektorin financiar për t'u shërbyer refugjatëve dhe praktikat më të mira të ndjekura nga ofruesit e shërbimeve financiare në vendin tonë.

Mikrofinanca Shqiptare dhe UNHCR Albania do të vijojnë bashkëpunimin edhe gjatë vitit 2025 me qëllim krijimin e një situate mundësuese për refugjatët dhe azilkërkuesit për të pasur akses në shërbimet financiare dhe integrimin e tyre të shpejtë në vendin tonë.

EDUKIMI FINANCIAR

Tetor 2024, Tetor 2024, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare i bashkohet Fushatës Mikrofinanca për Sipërmarrësit e rinj 2024 për të vënë në pah rolin thelbësor të sektorit të mikrofinancës në fuqizimin e sipërmarrësve të rinj.

Kjo fushatë e organizuar nga Microfinance Centre (MFC) vë në dukje rolin thelbësor të sektorit mikrofinanciar në fuqizimin e sipërmarrësve të rinj.

Sipas Missing Entrepreneurs 2023, rreth 40% e të rinjve në BE, nga mosha 15 deri në 30 vjeç, aspirojnë të vetëpunësohen.Megjithatë, barrierat si aftësitë e kufizuara sipërmarrëse, mundësitë e kufizuara të rrjetëzimit dhe aksesi i kufizuar në financa vazhdojnë të pengojnë aftësinë e të rinjve për të filluar biznese ose për t'u vetëpunësuar, pavarësisht rritjes së mbështetjes.

Për më tepër rreth fushatës: https://mfc.org.pl/borrow-wisely-campaign-2024/

11 Mars 2024, Në kuadër të edukimit financiar u finalizua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Mikrofinanca Shqiptare dhe Caritas Albania - Shqiptar e cila ka për qëllim përfshirjen e të rinjve të programit YourJob në tregun e punës duke u bërë pjesë e institucioneve anëtare të AMA.

Të pranishëm në këtë event, ishin Drejtoresha e Caritas Shqiptar - Znj. Juljana Reso si dhe Presidentja e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare - Znj. Arlinda Muja të cilat nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit së bashku me një pjesë të anëtarëve të bordit të AMA-s.

Programi do të kontribuojë në punësimin e të rinjve dhe krijimin e mundësive konkrete të punësimit për të rinjtë (SDG 1, 4, 5 dhe 8,)

TAKIME ME INVESTITORË & PARTNERË NDËRKOMBËTARË

21 Nëntor 2024, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare dhe IFC – Korporata Ndërkombëtare Financiare nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi për të bashkuar forcat në zgjerimin shërbimeve financiare digjitale dhe ekosistemit fintech, si dhe rritjen e funksionalitetit dhe efikasitetit të sistemeve të informacionit të kredisë në Shqipëri.

Marrëveshja vjen si një gur historik në një moment kur vendi po bën progres të rëndësishëm në përqafimin e transformimit digjital mbi bazën e sektorit publik dhe atij privat.

Shtyllat mbi të cilat do të bazohet ky bashkëpunim janë si më poshtë:

Rritja e ndërgjegjësimit të sektorit të mikrofinancës shqiptare rreth Onboarding Digjital dhe praktikave më të mira globale elektronike Njih klientin tënd (eKYC);

Ndarja e informacionit mbi qasjet globale të rregullatorit dhe standardet rregullatore globale për të lehtësuar përafrimin më të ngushtë me standardet e BE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare;

Ndarja e praktikave më të mira për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve financiare dixhitale inovative;

Ndarja e praktikave më të mira për rezistencën kibernetike dhe luftimi i mashtrimit në sektorin financiar;

Ndani praktikat më të mira për përdorimin e kreditit në sistemet e informacionit;

Ndani materiale dhe siguroni asistencë teknike për të mbështetur fushatat e edukimit financiar në nivel tregu ;

Marrëveshja u nënshkrua nga znj. Arlinda Muja, Presidente e Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancës dhe Z. Nicolas Marquier, Menaxher Rajonal për Ballkanin Perëndimor për Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC). Ne mezi presim që strategjitë dhe planet e veprimit të miratuara reciprokisht të vijnë në jetë në mbështetje të zhvillimit të vazhdueshëm të shërbimeve digjitale në Shqipëri.

PJESËMARRJE NË TAKIME DHE AKTIVITETE

23 Janar 2024, Drejtues ekzekutivë të institucioneve anëtarë të AMA ishin pjesë e takimit "Forcimi dhe Siguria Kibernetike në institucionet financiare" të organizuar nga Autoriteti Kombëtar CESK .Në takim, Koordinatori Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, z. Igli Tafa, theksoi rëndësinë e rolit të investimeve në këtë sektor të infrastrukturave kritike për rritjen e sigurisë kibernetike. Të pranishmit u njohën me domosdoshmërinë e forcimit dhe mbrojtjes kibernetike të institucioneve duke u fokusuar në disa hapa:

-Investime në Teknologji - nevoja për përdorimin e teknologjive të fundit të mbrojtjes kibernetike për të mbrojtur informacionin dhe të dhënat e klientëve.

-Masat Operacionale - ngritja e standarteve të sigurisë së përditshme të institucionit nga ana operacionale dhe administrative sipas referencave NIST ose ISO 27001.

-Niveli Menaxherial - roli i lidership-it në detyrimin e institucionit për të investuar në ngritjen e ndërgjegjësimin e stafit në kuadër të sigurisë kibernetike, në përcaktimin e buxhetit në fushën e sigurisë kibernetike si edhe në përcaktimin e rrezikut kibernetik në mënyrë të vazhdueshme.

-Rritja e Kapaciteteve - Investim në rritjen profesionale të eksperteve dhe mbulimin e vakancave të evidentuara në fushën e sigurisë kibernetike.

-Në takim u theksua nevoja e rritjes së bashkëpunimit mes AKCESK dhe sektorit financiar për të ndarë sa më shumë informacion dhe për të ndërmarrë masat e duhura, në kohën e duhur, që sigurojnë një ekosistem të sigurtë kibernetik.

12 Nëntor 2024,Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mori pjesë në mbledhjen e radhës të Këshillit të Investimeve. Këshilli i Investimeve u mblodh , nën drejtimin e ministrit Blendi Gonxhja, për të diskutuar sfidat e biznesit në lidhje me aksesin në financë. Në një dialog bashkëpunues, përfaqësues të biznesit vendas, qeverisë dhe partnerëve për zhvillim shqyrtuan mundësitë për zgjerimin e opsioneve të përballueshme të financimit dhe thjeshtimin e procedurave për mbështetjen e bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme në rrugën e tyre drejt rritjes dhe inovacionit. Qasja në kredi është thelbësore për zhvillimin e bizneseve, dhe takimi i sotëm evidentoi disa hapa praktikë për t'i bërë këto burime më të aksesueshme për të gjithë.

Tetor 2024, Publikim i gjetjeve si rezultat i bashkëpunimit të përbashkët midis Sekretariatit të Këshillit të Investimeve dhe Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare

Gjetjet e Anketës -Perspektiva e Mikrofinancës mbi financimin e ndërmarrjeve

Anketa shqyrton qasjen e mikrofinancës ndaj financimit të Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM). Gjetjet tregojnë se institucionet jo-bankare luajnë një rol të rëndësishëm në financimin e NMVM-ve që nuk shërbehen sa duhet nga bankat, duke ofruar kredi të shpejta dhe fleksibilitet, dhe duke adresuar sfida si njohuritë e ulëta financiare dhe kërkesat "e tepërta" të dokumentacionit bankar.

Lexoni me poshtë:

https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2024/12/Gjetjet-e-Anketes-Perspektiva-e-Mikrofinances-mbi-Financimin-e-Ndermarrjeve.pdf

BASHKËPUNIMI ME RRJETET NDËRKOMBËTARE

31 Tetor 2024-1 Nentor 2024, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare bashkëorganizatore e Konferencës Rajonale të Mikrofinancës MICROBALKANS 2024,në Sarajevë të Bosnjë Hercegovinës. Kjo konferencë përfaqëson një ngjarje të rëndësishme jo vetëm për sektorin e mikrokredisë në rajon, por edhe më gjerë. Qëllimi është të bashkojë ekspertë nga fusha të ndryshme për të diskutuar tema kyçe si dixhitalizimi, iniciativat ESG me fokus në tranzicionin energjetik dhe rolin e grave në sektor, si dhe kuadrin rregullator të domosdoshëm.

Konferenca do të ofrojë një mundësi për shkëmbim njohurish, rrjetëzim dhe krijimin e partneriteteve të reja.

Udhëheqësit e panelit dhe të tryezës së rrumbullakët, si dhe prezantimi i përfundimeve të konferencës së parë rajonale, do të jenë përfaqësues të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në Konferencën rajonale, Memorandumi i Mirëkuptimit do të nënshkruhet nga përfaqësuesit e Asociacionit të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe anëtarët individualë që nuk kanë një Asociacion të themeluar. Memorandumi i Mirëkuptimit do të përfaqësojë një skicë të qëllimeve të përbashkëta dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Qëllimi i kësaj konference është të bashkojë ekspertë nga sektori i mikrokredisë dhe palë të interesuara nga rajoni dhe jashtë vendit për të diskutuar temat kryesore që formësojnë të ardhmen e sektorit. Përmirësojë bashkëpunimin: Krijojë një platformë për shoqërimin e shoqatave të institucioneve të mikrokreditit të vendeve të Ballkanit Perëndimor me qëllim që të veprojnë së bashku ndaj palëve të interesuara, fondeve evropiane dhe Komisionit Evropian.

PREZENCA NË MEDIA DHE INFORMIMI I PUBLIKUT

24 Maj 2024 Njoftim për shtyp

Duke marrë shkas nga zhvillimet e fundit në drejtim të masave ligjore të ndërmarra kundrejt disa shoqërive të mbledhjes së kredive në vonesë dhe individëve të lidhura me to në drejtim të praktikave jo-etike, apo më tej, të paligjshme të mbledhjes së detyrimeve të qytetarëve dhe bizneseve, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare dëshiron tí referohet një njoftimi të saj për mediat, të publikuar në datë 19 korrik 2022 për të njëjtën çështje, dhe të risjellë në vëmendjen e publikut deklaratën sa më poshtë: "Shoqata Mikrofinanca Shqiptare dhe Anëtarët e saj i binden Kodit të Sjelljes dhe të Praktikave të Mira, miratuar me Vendim të posacëm të Asamblesë së Anëtarëve, dhe në këtë kuadër nuk adoptojnë dhe as ndjekin praktika të paligjshme apo jo-etike në veprimtarinë e tyre. Cdo anëtar i kesaj Shoqate vepron në përputhje me kuadrin legjislativ dhe rregullator në fuqi, i konfirmuar nga licensimi dhe mbikëqyrja periodike e Bankës së Shqipërise, dhe cdo shmangie nga ky kuadër adresohet me masa të posaçme ligjore ose administrative. *Për më tepër deklarata e plotë: https://ama.com.al/njoftim-per-mediat-3/*

22 Mars 2024,Intervistë me z.Bardhi Sejdarasi në RTSH.

Në një vështrim të plotë mbi #mikrofinancashqiptare flasin sot në RTSH24, z. Deniz Dërralla, Drejtor i Mbikqyrjes pranë Banka e Shqipërisë dhe zj. Arlinda Muja, Presidente e Mikrofinanca Shqiptare

Si funksionojnë dhe si vendosen normat e interesit të kredive? Si janë kredituar 213 mijë klientë me më shumë se 50 miliardë lekë? Çfarë lidhje kanë kompanitë që japin kredi me kompanitë që mbledhin borxhet e këqija?

Shumë informacion utilitar, me gjuhë të kuptueshme nga dy ekspertë ekselentë të sektorit!!

https://www.youtube.com/watch?v=O-SIYFSEfzs

7 Qershor 2024

Znj. Brunilda Isaj, Sekretare e Përgjithshme e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, ishte e ftuar në Scan TV për të diskutuar në lidhje me zhvillimet e fundit në sektorin e mikrofinancës. Në fjalën e saj ajo u ndal në një tablo të sektorit dhe evolucionit të tij ndër vite, si edhe bëri një përshkrim të tipologjive të institucioneve të mikrofinancës.

E pyetur në lidhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të sektorit dhe ndikimit të tij në veprimtarinë mikrofinanciare, znj. Isaj u shpreh se ndërkohë që ndryshimet rregullatore për vendosjen e tavanit të normave të interesit mund të kenë ulur kostot për klientët, ato e kanë bërë kredidhënien në fasha të caktuara të pamundur për institucionet e mikrofinancës për shkak se kostot shkojnë përtej tavanit të vendosur të normës së interesit. Kjo mund të rezultojë në përjashtimin financiar të një pjese të mirë të popullatës, gjë e cila mund të ketë pasoja në nivelin ekonomik dhe financiar të tyre.

Në lidhje me mundësinë e një ligji të ri për institucionet financiare jo-banka, znj. Isaj sugjeroi që ky ligj së pari të konsultohet me grupet e interesit, dhe së dyti të shohë mundësinë e gjetjes së rrugëve për të ulur koston e fondeve për institucionet, e cila do të materializohet në kosto më të ulët për klientin fundor. Ajo u shpreh se pavarësisht emetimt të suksesshëm të instrumentave financiare të borxhit nga NOA në Bursën Shqiptare, kostot e gjenerimit të likuiditetit mbeten të larta, ndaj do ishte mirë që në ligjin e ri të konsiderohej edhe mundësia e mbledhjes së mikrodepozitave nga publiku si një linjë financimi e veprimtarisë kredidhënëse për institucionet tona"

https://www.youtube.com/watch?v=F8j9vJ6sPpI

8 Qershor 2024

Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare znj.Brunilda Isaj ishte e ftuar në Report TV, ku së bashku me gazetarin e ekonomisë Fatos Cocoli diskutuan problematikën e krijuar nga praktikat jo-etike dhe jo-ligjore të disa kompanive të mbledhjes së kredive të këqija.

Ajo u ndal gjithashtu në rëndësinë e përcaktimit të një kuadri të plotë ligjor dhe regullator për rregullimin e këtyre praktikave, si edhe në nevojën e sektorit për gjetjen e mënyrave për të rritur edukimin financiar dhe forcuar komunikimin me klientin.

https://www.youtube.com/watch?v=ZwxPpmL8X8c

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2024

15 Korrik 2024

Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, znj. Brunilda Isaj, ishte e ftuar në A2 Business ku foli në lidhje me tendencat e kreditimit në sektorin financiar. Ajo u shpreh se kërkesa e tregut vijon të mbetet pozitive qoftë nga ana e bizneseve, ashtu edhe nga ana e individëve, duke reflektuar një nivel të lartë besimi në ekonomi.

Sa i takon situatës së krijuar me mbledhjen e kredive të këqija, ajo u shpreh që kompanitë e mbledhjes së borxhit kanë vepruar në kushtet e hapësirave ligjore që u kanë lejuar praktika abuzive me klientët. Megjithatë, deklaroi ajo, situata e krijuar nuk ka ndikuar në marrëdhëniet me klientët e mikrofinancës, të cilët punojnë prej vitesh me institucionet tona dhe janë rritur në vijimësi.

Mesazhi që përcjellim tek klientët tanë është që të respektojnë ripagimet e detyrimeve për të shmangur kostot e shtuara të lidhura me procesin, ndërkohë që jemi të hapur për të trajtuar kërkesat për ristrukturim detyrimesh apo shtyrje të tyre.

https://www.youtube.com/watch?v=YghkW0dhSKc

20 Korrik 2024

Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, znj.Brunilda Isaj bashkëbisedoi me gazetarin e mirënjohur të ekonomisë në RTSH Radio Televizioni Shqiptar, Bardhi Sejdarasi në lidhje me skemën e mashtrimit me kreditë me probleme, pozicionimin e Shoqatës karshi këtij fenomeni dhe disa opinione mbi ndryshimet që mund të aplikohen në kuadrin ligjor dhe rregullativ, që të mund të shmangen praktikat abuzuese.

https://www.youtube.com/watch?v=IfA-af6Mjm8

28 Shtator 2024

Presidentja e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, znj. Arlinda Muja ishte e ftuar tek ABC News Albania, ku foli për zhvillimet e sektorit të mikrofinancës dhe arritjet e tij gjatë viteve të fundit. Ajo u ndal në specifikat e produkteve dhe shërbimeve financiare që ofron mikrofinanca, ndërthurja e tyre me teknologjinë dhe ofrimi i zgjidhjeve për mijëra qytetarë, fermerë dhe biznese.

Sektori aktualisht përballet me shumë sfida që kanë të bëjnë me edukimin finaciar, nivelin e të kuptuarit të teknologjisë financiare dhe pamundësinë për të ofruar shërbime me kosto më të ulëta.Megjithatë, sektori është i vendosur të bashkëpunojë me rregullatorin dhe aktorët e tregut për të ofruar shërbime cilësore në vijimësi dhe mbrojtur dhe edukuar konsumatorin në lidhje me produktet financiare.

https://abcnews.al/sheshi-i-dollarit-me-bardh-sejdarasin-27-09-2024/?fbclid=IwY2xjawMAeHdleHRuA2FlbQIxMQABHpmmBKGDwk7mWb6g2_yjskNOlKpHiTtjLu8R4j4WNjFS3avT5rdUAjW_i1ry_aem_rAfP32TqXtAKRll7p4pjOQ

6 Tetor 2024

Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare , znj. Brunilda Isaj ishte e ftuar në emisionin #ezone në VIZION PLUS ku së bashku me gazetaren e mirënjohur të ekonomisë Monda Lajthia diskutoi në lidhje me #ndikimin që pritet të kenë në veprimtarinë e mikrofinancës #ndryshimet e fundit të kuadrit rregullator të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë.

https://www.youtube.com/watch?v=lX4XOnipH4w

26 Tetor 2024,

Në një intervistë për SCAN TV, Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, Brunilda Isaj, u shpreh se formalizimi i pagave ndihmon aksesin në financime, përmirëson proceset e admininstrimit të rreziqeve dhe ul kostot e financimit.

Ajo u shpreh se sektori i mikrofinancës ka si avantazh konkurrues shpejtësinë, fleksibilitetin dhe konveniencën që i ofron klientit, dhe nuk diferencohet vetëm nga qasja në financa e tregut informal.

https://scantv.al/aksioni-i-informalitetit-si-preken-bankat-dhe-mikrofinanca-isaj-deklarimi-real-i-pagave-rrit-aksesin-e-qytetareve-ne-finance/?fbclid=IwY2xjawMAeTpleHRuA2FlbQIxMQABHuGlRWbHcy4I9Tb3d0ypSbGB9dx2hN3h4BU_RChsAoQ4PMT8cLpv8f0kfRCL_aem_Y-TlOyuUiSHMn91nt5tPMg

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Albanian Microfinance Association

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2024